8. Procesi sipas pretendimit 7, kur është në varësi të secilit prej pretendimeve 2 deri në 6, ku pentafluoropropani është 1,1,1,2,2-pentafluoropropan.

---

(11) **13764**
(97) EP4447452//27.05.2026
(96) 24197459.1//10.10.2017
(22) 24.08.2026
(21) AL/P/2026/510
(54) **METODË DHE PAJISJE PËR KODIMIN/ÇKODIMIN E TË DHËNAVE TË IMAZHIT**
19.10.2026
(30) KR KR 20160127893 04/10/2016, KR KR 20160129391 06/10/2016, KR KR 20170090621 17/07/2017
(71) B1 Institute of Image Technology, Inc./1213-ho, 525, Gonghangdae-ro
Gangseo-gu, Seoul 07563 / KR KR//

(72) Ki Beak KIM/Seogu, Daejeon 35206 / KR,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. . Një metodë për çkodimin e një imazhi 360-gradë, metodë që përfshin: marrjen e një sekuence njësie dixhitale në të cilën është koduar imazhi 360-gradë, sekuencë njësie dixhitale që përfshin të dhënat e një imazhi 2-dimensional të zgjeruar (S1), imazh 2-dimensional i zgjeruar që përfshin një imazh 2-dimensional (S0) dhe një zonë të paracaktuar zgjeruese, imazh 2-dimensional që projektohet nga një imazh me një strukturë projeksioni 3-dimensionale, dhe imazhi 2-dimensional që përfshin të paktën një faqe (A) ; dhe rindërtimin e imazhit të zgjeruar 2-dimensional duke çkoduar të dhënat e një imazhi të zgjeruar 2-dimensional, ku rindërtimi i imazhit të zgjeruar 2-dydimensional përfshin kryerjen e parashikimit për një bllok të përfshirë në imazhin të zgjeruar 2-dimensional që përfshin imazhin 2-dimensional dhe zonën e paracaktuar zgjeruese, që karakterizohet në atë që: - nje përmasë e zonës zgjeruese përcaktohet bazuar në informacionin e parë të gjerësisë (Exp_L) të zonës zgjeruese në anën e majtë të faqes dhe informacionin e dytë të gjerësisë (Exp_R) të zonës zgjeruese në anën e djathtë të faqes, të dy si informacioni i parë i gjerësisë ashtu edhe informacioni i dytë i gjerësisë merren nga sekuenca e njësive dixhitale, - secili prej informacionit

të parë të gjerësisë dhe informacionit të dytë gjerësisë kufizohet për të treguar një numër çift mostrash ndriçuese sipas një formati ngjyrash të imazhit 2-dimensional, - vlerat mostër të zonës zgjeruese përcaktohen sipas një metode gjeneruese që përdor vlerat mostër të faqes, metodë gjeneruese që zgjidhet nga një tërësi metodash gjeneruese duke përfshirë një metodë që modifikon vlerat mostër të faqes për vlerat mostër të zonës zgjeruese, dhe – metoda gjeneruese për njërën anë të faqes përcaktohet në mënyrë të ndryshme nga metoda gjeneruese nga ana tjetër e faqes.

2. Metodë sipas pretendimit 1, ku metoda gjeneruese zgjidhet nga një tërësi metodash gjemeruese bazuar në informacionin seleksionues të marrë nga sekuenca e njësisë dixhitale.

3. Një metodë për kodimin e një imazhi 360-gradë, metodë që përfshin: marrjen e një imazhi 2-dimensional (S0) i projektuar nga një imazh me një strukturë projeksioni 3-dimensionale, dhe imazhi 2-dimensional që përfshin të paktën një faqe (A) ; marrjen e një imazhi të zgjeruar 2-dimensional (S1) që përfshin imazhin 2-dimensional dhe një zonë të paracaktuar zgjeruese; dhe kodimin e të dhënave të imazhit të zgjeruar 2-dimensional në një sekuence njësie dixhitale në të cilën kodohet imazhi 360-gradë, ku kodimi i të dhënave të imazhit të zgjeruar 2-dimensional përfshin kryerjen e parashikimit për një bllok të përfshirë në imazhin e zgjeruar 2-dimensional duke përfshirë imazhin 2-dimensional dhe zonën e paracaktuar zgjeruese, që karakterizohet në atë që: - një përmasë e zonës zgjeruese kodohet bazuar në informacionin e parë të gjerësisë (Exp_L) të zonës zgjeruese në anën e majtë të faqes dhe informacionin e dytë të gjerësisë (Exp_R) të zonës zgjeruese në anën e djathtë të faqes, të dy si informacioni i parë i gjerësisë ashtu edhe informacioni i dytë i gjerësisë kodohen në sekuencën e njësisë dixhitale, - secili prej informacionit të parë të gjerësisë dhe informacionit të dytë të gjerësisë kufizohet të tregojë një numër çift mostrash ndriçuese sipas një formati ngjyrash të imazhit 2-dimensional, - vlerat mostër të zonës zgjeruese përcaktohen në përputhje me një metodë gjeneruese e cila përdor vlerat mostër të faqes, ku metoda gjeneruese zgjidhet nga një tërësi metodash gjeneruese duke përfshirë një metodë gjeneruese që modifikon vlerat mostër të faqes për vlerat mostër të zonës zgjeruese, dhe -metoda gjeneruese për një anë të faqes përcaktohet në mënyrë të ndryshme nga metoda gjeneruese nga ana tjetër e faqes.

4. Një metodë për transmetimin e një sekuence njësie dixhitale, metodë që përfshin: marrjen e një imazhi 2-dimensional (S0) të projektuar nga një imazh me një strukturë projeksioni 3-dimensionale, dhe imazhi 2-dimensional që përfshin të paktën njërën faqe; marrjen e një imazhi të zgjeruar 2-dimensional (S1) që përfshin imazhin 2-dimensional dhe një zonë të paracaktuar zgjeruese; kodimin e të dhënave të imazhit të zgjeruar 2-dimensional në një sekuence njëse dixhitale në të cilën është koduar imazhi 360-gradë; dhe transmetimin e sekuencës së njësisë dixhitale, ku kodimi i të dhënave të imazhit të zgjeruar 2-dimensional përfshin kryerjen e parashikimit për një bllok të përfshirë në imazhin e zgjeruar 2-dimensional që përfshin imazhin 2-dimensional dhe zonën e paracaktuar zgjeruese, që karakterizohet nga fakti se: - një madhësi e zonës zgjeruese kodohet bazuar në informacionin e parë të gjerësisë (Exp_L) të zonës zgjeruese në anën e majtë të faqes dhe informacionin e dytë të gjerësisë (Exp_R) të zonës zgjeruese

në anën e djathtë të faqes, të dy si informacioni i parë i gjerësisë ashtu edhe informacioni i dytë i gjerësisë kodohen në sekuencën e njësisë dixhitale, - secili prej informaciont të parë të gjerësisë dhe informacionit të dytë të gjerësisë kufizohet për të treguar një numër çift mostrash ndriçuese sipas një formati ngjyrash të imazhit 2-dimensional, - vlerat mostër të zonës zgjeruese përcaktohen sipas një metode gjeneruese e cila përdor vlerat mostër të faqes, metodë gjeneruese që zgjidhet nga një tërësi metodash gjeneruese duke përfshirë një metodë gjeneruese e cila modifikon vlerat mostër të faqes për vlerat mostër të zonës zgjeruese, dhe - metoda gjeneruese për njërën anë të faqes përcaktohet në mënyrë të ndryshme nga metoda gjeneruese nga ana tjetër e faqes.

---

(11) **13815**
(97) EP4017970//03.06.2026
(96) 20780376.8//24.08.2020
(22) 25.08.2026
(21) AL/P/2026/511
(54) **PROCESI PËR PRODHIMIN E LIMFOCITEVE T SPECIFIKE PËR ANTIGEN**
03.11.2026
(30) PL PL20190430932 22/08/2019
(71) Gdanski Uniwersytet Medyczny/ul. M. Sklodowskiej-Curie 3a, 80-210 Gdansk / PL PL//

(72) Piotr TRZONKOWSKI/ul. Dziewanowskiego 6/2 80-754 Gdansk / PL,
Dorota IWASZKIEWICZ-GRZES/ul. Chalubinskiego 5/40 80-807 Gdansk / PL,
Mateusz GLIWINSKI/ul. Lamana 3 82-500 Kwidzyn / PL,
(74) Melina Nika//
Rruga Fadil Rada, Pallati Gener 2, Shkalla C, Nr 2/1, Tirane
(57) 1. Proces për prodhimin e limfociteve T specifike për antigjenin të shënuara me antitrupa monoklonalë dhe të seleksionuara, ku limfocitet: a) gjenerohen nga përdorimi i monociteve autologe CD14+ të ngarkuara me antigjenin; b) Limfocitet rregullatore T pezullohen në PBS dhe ngjyrosen në mënyrë intraqelizore me një ngjyrues fluoreshent; c) limfocitet më pas inkubohen në errësirë; d) qelizat limfocite më pas lahen intensivisht disa herë me mjedis kulture; e) Limfocitet rregullatore T të ngjyrosura me ngjyrues fluoreshent intraqelizor pezullohen në mjedisin e kulturës me monocite autologe CD14+ të rrezatuara me gama, të ngarkuara me antigjen; f) bashkëkultura e limfociteve rregullatore T ose limfociteve me monocite CD14+ bashkëinkubohet me antitrupa antiCD154 dhe anti-CD28; g) bashkëkultura inkubohet në mjedis kulture; dhe h) limfocitet T specifike për antigjenin pas inkubimit renditen bazuar në intensitetin e ulët të ngjyruesit intraqelizor, ku intensiteti i ulët i fluoreshencës është një shënues i specifikës së antigjenit, në atë që një humbje e fluoreshencës korrelon me intensitetin e përhapjes.
2. Procesi sipas pretendimit 1, karakterizuar në atë që T rregullatorët janë pezulluar në përqendrimin e mëposhtëm: 1x106 qeliza/ml PBS.
3. Procesi sipas pretendimit 1, karakterizuar në atë që limfocitet ngjyrosen me një nga ngjyrat fluoreshente të mëposhtme: CFSE ose Vjollcë Blu në përqendrimin

përfundimtar 15μM.
4. Procesi sipas pretendimit 1, karakterizuar në atë që, në hapin c), limfocitet inkubohen për 20 minuta në temperaturë ambienti ose në 37°C.
5. Procesi sipas pretendimit 1, karakterizuar në atë që monocitet autologe shtohen në bashkëkulturë në raportin përfundimtar monocit:limfocit prej 1:1.
6. Procesi sipas pretendimit 1 karakterizuar në atë që, në hapin e), monocitet rrezatohen me gama.
7. Procesi sipas pretendimit 1 karakterizuar në atë që bashkëkultura e monociteve dhe limfociteve autologe CD14+ inkubohet me antitrupa anti-CD154 në përqendrimin përfundimtar prej 5μg/ml dhe antitrupa anti-CD28 në përqendrimin përfundimtar prej 5μg/ml.
8. Procesi sipas pretendimit 1 karakterizuar në atë që, në hapin g), bashkëkultura inkubohet në 37°C në 5% CO2.
9. Procesi sipas pretendimit 1 karakterizuar në atë që specificiteti ndaj antigjenit vlerësohet në testet funksionale në të cilat limfocitet T specifike për antigjenin janë më aktive sesa limfocitet T jo specifike, ku aktiviteti në rastin e limfociteve rregullatore T përcaktohet si shtypja e funksionit të limfociteve efektore T.
10. Procesi sipas pretendimit 9 karakterizuar në atë që limfocitet T specifike për antigjenin janë limfocite T të renditura në bazë të fluoreshencës së ulët të ngjyrosësit intraqelizor.
11. Procesi sipas pretendimit 9 karakterizuar në atë që limfocitet T jo specifike janë limfocite T të renditura në bazë të fluoreshencës së lartë të ruajtur të ngjyrosësit intraqelizor.

---

(11) **13816**
(97) EP4252777//17.06.2026
(96) 23179487.6//19.03.2021
(22) 25.08.2026
(21) AL/P/2026/512
(54) **FORMULIME TË ANTITRUPAVE ME PËRQENDRIM TË LARTË ANTI-AMILOID BETA PEPTIDE PROTOFIBRIL DHE METODAT E PËRDORIMIT TË TYRE**
03.11.2026
(30) US US 202062992746 P 20/03/2020, US US 202063027263 P 19/05/2020
(71) Eisai R&D Management Co., Ltd./6-10 Koishikawa, 4-Chome
Bunkyo-Ku
Tokyo 112-8088 / JP JP//

(72) Nobuo Yoshida/Tokyo, 112-8088 / JP,
Naomi Sakuramoto/Kakamigahara-shi, Gifu, 501-6195 / JP,
Takahisa Sakaguchi/Kakamigahara-shi, Gifu, 501-6195 / JP,
Hirokazu Kito/Kakamigahara-shi, Gifu, 501-6195 / JP,
Takahiro Ozawa/Kakamigahara-shi, Gifu, 501-6195 / JP,
Anjali Joshi/Cary, North Carolina, 27519 / US,
Yung Yueh Hsu/Carlisle, Massachusetts, 01741 / US,
Pierre Souillac/Winchester, Massachusetts, 01890 / US,

(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Një metodë për reduktimin e formimit të agregatit të një antitrupi të izoluar anti-Aβ protofibril, që përfshin: duke siguruar një formulim farmaceutik ujor që përmban një antitrup të izoluar anti-Aβ protofibril në një përqendrim prej 80 mg/ml deri në 300 mg/ml, dhe duke shtuar arginine, arginine hidrokloride, ose një kombinim të tyre në formulimin farmaceutik ujor të sipërpërmendur, ku pH i formulimit farmaceutik varion nga 4.5 në 5.5, dhe ku antitrupi i izoluar anti-Aβ protofibril është lecanemab.
2. Metoda sipas pretendimit 1, ku arginine, arginine hidrokloride, ose kombinimi i tyre është i pranishëm në një përqendrim prej 150 deri në 250 mM.
3. Metoda sipas pretendimit 2, ku arginine, arginine hidrokloride, ose kombinimi i tyre është i pranishëm në një përqendrim prej 200 mM.
4. Metoda sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 3, ku formulimi farmaceutik përfshin më tej një zbutës farmaceutikisht të pranueshëm.
5. Metoda sipas pretendimit 4, ku zbutësi farmaceutikisht i pranueshëm është zbutësi i histidinës ose zbutësi i citratit.
6. Një metodë për reduktimin e fragmentimit të një antitrupi të izoluar anti-Aβ protofibril, që përfshin: duke siguruar një formulim farmaceutik ujor që përmban një antitrup të izoluar anti-Aβ protofibril në një përqendrim prej 80 mg/ml deri në 300 mg/ml, dhe duke shtuar zbutësin e histidinës në kompozimin farmaceutik ujor të sipërpërmendur, ku pH i formulimit farmaceutik varion nga 4.5 në 5.5, dhe ku antitrupi i izoluar anti-Aβ protofibril është lecanemab.
7. Metoda sipas pretendimit 6, që përfshin një zbutës histidine prej 15 deri në 35 mM.
8. Metoda sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 7, ku formulimi farmaceutik përfshin më tej 0.01% w/v deri në 0.1% w/v polisorbate 80.
9. Metoda sipas pretendimit 1, ku formulimi farmaceutik ujor ruhet në 25°C për 3 muaj.
10. Një formulim farmaceutik që përfshin: (a) një antitrup të izoluar anti-Aβ protofibril në një përqendrim prej 80 mg/mL deri në 300 mg/mL, dhe (b) zbutës histidine, ku formulimi farmaceutik ka një pH që varion nga 4.5 në 5.5, dhe ku antitrupi i izoluar anti-Aβ protofibril është lecanemab.
11. Formulimi farmaceutik sipas pretendimit 10, ku antitrupi i izoluar anti-Aβ protofibril është i pranishëm në një përqendrim prej 100 mg/mL deri në 200 mg/mL.
12. Formulimi farmaceutik sipas pretendimit 10, ku antitrupi i izoluar anti-Aβ protofibril është i pranishëm në një përqendrim prej 100 mg/mL ose 200 mg/mL.
13. Formulimi farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 10-12, që përfshin më tej 0.01% w/v deri në 0.1% w/v polisorbate 80.
14. Formulimi farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 10-13, ku zbutësi i histidinës është i pranishëm në një përqendrim prej 25 mM.
15. Formulimi farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 10-14, ku zbutësi i histidinës përfshin histidine dhe histidine hidrokloride monohidrate.

---

(11) **13818**

(97) EP4406598//29.07.2026
(96) 24179087.2//12.06.2018
(22) 25.08.2026
(21) AL/P/2026/514
(54) **PEPTIDI TPX-100 PËR LEHTËSIMIN E DHIMBJES SË KYÇIT TË GJURIT**
03.11.2026
(30) US US 201762519538 P 14/06/2017
(71) OrthoTrophix, Inc./303 Hegenberger Road, Suite 312
Oakland, CA 94621 / US US//

(72) Yoshinari KUMAGAI/CA, 94404 / US,
Dawn MCGUIRE/CA, 94563 / US,
Meghan MILLER/CA, 84531 / US,
David ROSEN/CA, 94621 / US,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Një formulim për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit te një subjekt, ku formulimi përfshin: ujë dhe një peptid që përbëhet nga një sekuencë aminoacide TDLQERGDNDISPFSGDGQPFKD (SEQ. ID No:1) të kombinuar në një formulim ujor të injektueshëm, ku përdorimi përfshin injektimin te një kyç i subjektit, përmes së cilit formulimi redukton dhimbjen e kyçit të gjurit te subjekti
2. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit sipas pretendimit 1, ku subjekti vuan nga të paktën një nga osteoartriti, artriti reumatoid ose trauma në kyçin e gjurit me dhimbje.
3. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit sipas pretendimit 1, ku subjekti nuk shfaq ndonjë ndryshim të dallueshëm në kërcin e kyçit të gjurit.
4. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit siç pretendohet në pretendimin 1, ku formulimi përfshin më tej acid hialuronik.
5. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit siç pretendohet në secilin prej pretendimeve 1 deri në 4, ku përdorimi është intra-artikular.
6. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit siç pretendohet në secilin prej pretendimeve 1 deri në 5, ku pacienti është diagnostikuar se përjeton dhimbje të kyçit të gjurit kur pacienti është duke kryer një aktivitet që sforcon kyçin e gjurit.
7. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit siç pretendohet në secilin prej pretendimeve 1 deri në 6, ku aktiviteti që sforcon kyçin është një shkallë përkuljeje e gjurit më e madhe sesa ajo e nevojshme për të ecur në një sipërfaqe të sheshtë.
8. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit sipas secilit prej pretendimeve 1 – 7, ku përdorimi kryhet te një pacient pas kryerjes së një vlerësimi të parë të shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit dhe para kryerjes së një vlerësimi të dytë

të shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit, ku vlerësimi i parë i shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit të pacientit është kryer duke përdorur një nënshkallë dhimbjeje të Indeksit të Osteoartritit të Universiteteve të Western Ontario dhe McMaster (WOMAC) ; dhe vlerësimi i dytë i shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit të pacientit është kryer duke përdorur WOMAC; përmes së cilit formulimi redukton shpeshtësinë e dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit te subjekti bazuar në një diferencë midis vlerësimit të parë dhe të dytë bazuar në WOMAC.

9. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit sipas secilit prej pretendimeve 1 – 7, ku përdorimi kryhet te një pacient pas kryerjes së një vlerësimi të parë të shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit dhe para kryerjes së një vlerësimi të dytë të shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit, ku vlerësimi i parë i shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit të pacientit është kryer duke përdorur një nënshkallë dhimbjeje të vlerësimit të rezultatit të lëndimit të gjurit dhe osteoartritit (KOOS) ; dhe vlerësimi i dytë i shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit të pacientit duke përdorur KOOS; ku formulimi redukton dhimbjen e kyçit të gjurit te subjekti bazuar në një diferencë midis vlerësimit të parë dhe të dytë bazuar në KOOS.

10. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit sipas secilit prej pretendimeve 1 – 7, ku përdorimi kryhet te një pacient pas kryerjes së një vlerësimi të parë të shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit dhe para kryerjes së një vlerësimi të dytë të shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit, ku vlerësimi i parë i shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit të pacientit është kryer duke përdorur një rezultat të përshtatshëm të raportuar nga pacienti lidhur me kyçin e gjurit në fjalë; dhe është kryer një vlerësim i dytë i shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit të pacientit duke përdorur të njëjtin rezultat të raportuar nga pacienti; përmes së cilit formulimi redukton dhimbjen e kyçit të gjurit te subjekti bazuar në një diferencë midis vlerësimit të parë dhe të dytë bazuar në rezultatin e raportuar nga pacienti.

11. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 10, ku formulimi krijohet duke kombinuar ujë me një pluhur të liofilizuar kripe natriumi të një peptidi që përbëhet vetëm nga një sekuencë aminoacide TDLQERGDNDISPSFSGDGQPFKD (SEQ. ID No: 1) ku sekuenca përfshin një skaj C të amiduar për të krijuar formulimin ujor të injektueshëm.

12. Formulimi për përdorim në reduktimin e shpeshtësisë së dhimbjes së përgjithshme të kyçit të gjurit sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 11, ku peptidi është administruar në një dozë në një diapazon prej 20 mg deri në 1200 mg për injeksion.

---

(11) **13765**
(97) EP4547175//29.07.2026
(96) 23748612.1//21.06.2023
(22) 26.08.2026

(21) AL/P/2026/519
(54) **TAPET PËRTHITHËS NJËPËRDORIMËSH DHE PROCESI I PRODHIMIT TË TIJ**
19.10.2026
(30) IT IT202200013720 29/06/2022
(71) Teknoweb Converting Srl/Via Dei Salici 7
26020 Palazzo Pignano (CR) / IT IT//

(72) Pierangelo MANDOTTI/26020 PALAZZO PIGNANO (CR) / IT,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Tapet përthithës njëpërdorimësh (100), kryesisht në formë katërkëndore, që përfshin: - një shtresë përthithëse të lëngjeve (1), e cila ka një gjatësi dhe gjerësi të paracaktuar që përkufizon një zonë efektive (23) ; - një fletë materiali të papërshkueshëm nga lëngjet (2), që ka një gjatësi dhe gjerësi të paracaktuar më të madhe se gjatësia dhe gjerësia e shtresës përthithëse në fjalë (1), të bashkuar dhe të shtrirë poshtë shtresës përthithëse në fjalë (1), në mënyrë që të përcaktojë një çift të parë (21) dhe të dytë (22) skajesh të lira të kundërta, të vendosura jashtë zonës efektive (23) që zë shtresa përthithëse në fjalë (1) ; - një fletë materiali të përshkueshëm nga lëngjet (3), të bashkuar dhe të mbivendosur mbi shtresën përthithëse në fjalë (1) në anën e kundërt në raport me fletën e materialit të papërshkueshëm nga lëngjet në fjalë (2), ku çifti i parë i skajeve të lira në fjalë (21) i fletës së materialit të papërshkueshëm nga lëngjet në fjalë (2) është kthyer për lart në zonën efektive në fjalë (23) që zë shtresa përthithëse në fjalë (1) për të përcaktuar mjetin e parë të mbylljes anësore të shtresës përthithëse në fjalë (1) kundër rrjedhjes së lëngjeve, në të cilën fleta e materialit të përshkueshëm nga lëngjet në fjalë (3) ka një gjatësi dhe gjerësi të paracaktuar të barabartë me gjatësinë dhe gjerësinë e shtresës përthithëse në fjalë (1) dhe në të cilën tapeti përthithës në fjalë (100) përfshin një shirit të parë (4) dhe të dytë (5) të materialit të papërshkueshëm nga lëngjet të vendosur përkatësisht midis secilit skaj të lirë të çiftit të dytë të skajeve të lira në fjalë (22) dhe fletës së materialit të përshkueshëm nga lëngjet në fjalë (3), ku shiriti i parë (4) dhe i dytë (5) në fjalë bashkohen të paktën me çiftin e dytë të skajeve të lira në fjalë (22) për të përcaktuar një mjet të dytë të mbylljes anësore të shtresës përthithëse në fjalë (1) kundër rrjedhjes së lëngjeve, të vendosur në mënyrë ortogonale në raport me mjetin e parë të mbylljes anësore në fjalë.
2. Tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas pretendimit 1, ku çifti i parë i skajeve të lira në fjalë (21) të fletës së materialit të papërshkueshëm nga lëngjet në fjalë (2) është kthyer për lart mbi materialin e përshkueshëm nga lëngjet në fjalë (3) .
3. Tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas pretendimit 2, ku shiriti i parë (4) dhe i dytë (5) në fjalë janë mbivendosur mbi fundet e mjetit të parë të mbylljes anësore në fjalë të formuar nga çifti i parë i skajeve të lira (21) që janë kthyer për lart.
4. Tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas pretendimit 2, ku shiriti i parë (4) dhe i dytë (5) në fjalë janë mbivendosur mbi fundet e mjetit të parë të mbylljes

anësore në fjalë të formuar nga çifti i parë i skajeve të lira (21) që janë kthyer për lart.
5. Tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas secilit prej pretendimeve pararendëse, në të cilin fleta e materialit të papërshkueshëm nga lëngjet në fjalë (2) përfshin polietilen.
6. Tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas secilit prej pretendimeve pararendëse, në të cilin fleta e materialit të përshkueshëm nga lëngjet në fjalë (3) përfshin pëlhurë hidrofile jo të endur.
7. Tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas secilit prej pretendimeve pararendëse, në të cilin shtresa përthithëse në fjalë (1) është e përbërë dhe përfshin të paktën një cipë (6) të bërë prej materiali hidrofil dhe një shtresë (7) celuloze përthithëse, ku të paktën një cipë në fjalë (6) është përballë fletës së materialit të papërshkueshëm nga lëngjet në fjalë (2) dhe shtresa e celulozës përthithëse në fjalë (7) është përballë fletës së materialit të përshkueshëm nga lëngjet në fjalë (3) .
8. Tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas secilit prej pretendimeve pararendëse, në të cilin shtresa përthithëse në fjalë (1), fleta e materialit të papërshkueshëm nga lëngjet në fjalë (2), fleta e materialit të përshkueshëm nga lëngjet në fjalë (3), çifti i skajeve në fjalë (21, 22) dhe shiritat në fjalë (4, 5) bashkohen së bashku me ngjitës (8) ose saldim.
9. Procesi për prodhimin e një tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas secilit prej pretendimeve 1 – 8, i cili përfshin hapat e: - sigurimit të një rrjete (20) prej materiali të papërshkueshëm nga lëngjet që ka një gjerësi të paracaktuar dhe e shpështjell atë sipas një drejtimi avancimi (x) ; - sigurimit të një morie shtresash përthithëse të lëngjeve (1), ku secila ka një gjatësi dhe gjerësi të paracaktuar, ku gjerësia në fjalë është më e vogël sesa gjerësia e rrjetës në fjalë (20) ; - sigurimit të një morie fletësh të materialit të përshkueshëm nga lëngjet (3), ku secila ka një gjatësi dhe gjerësi të paracaktuar të barabartë me gjatësinë dhe gjerësinë e shtresave përthithëse në fjalë (1) ; - bashkimit së bashku të shtresave përthithëse në fjalë (1) dhe fletëve të materialit të përshkueshëm nga lëngjet në fjalë (3) për të krijuar panele përthithëse me shumë shtresa (9) ; - vendosjes së paneleve përthithëse me shumë shtresa në fjalë (9) mbi rrjetën në fjalë (20) të materialit të papërshkueshëm nga lëngjet sipas drejtimit të avancimit në fjalë (x), me radhë dhe të distancuara, në mënyrë që të përcaktojnë, përgjatë rrjetës në fjalë (20), zonat efektive (23) dhe një çift të parë skajesh të lira të kundërta (21) përgjatë drejtimit të avancimit në fjalë (x) dhe zona të lira tërthore (24) në raport me drejtimin e avancimit në fjalë (x) ndërmjet çdo paneli përthithës me shumë shtresa (9) ; - kthimit për lart të çiftit të parë të skajeve të lira në fjalë (21) të rrjetës në fjalë (20) të materialit të papërshkueshëm nga lëngjet në zonat efektive në fjalë (23) që zënë panelet përthithëse me shumë shtresa në fjalë (9) për të përcaktuar mjetin e parë të mbylljes anësore të tapetit përthithës në fjalë (100) kundër rrjedhjes së lëngjeve; - sigurimit të shiritave (4, 5) të një materiali të papërshkueshëm nga lëngjet; - vendosjes së shiritave në fjalë (4, 5) midis të paktën një pjese të zonave të lira tërthore në fjalë (24) dhe zonave efektive në fjalë (23) që zënë panelet përthithëse me shumë shtresa në fjalë (9) për të përftuar një mjet të dytë të mbylljes anësore kundër rrjedhjes së lëngjeve, të vendosur në mënyrë ortogonale në raport me mjetin e parë të mbylljes anësore në fjalë; - prerjes në mënyrë tërthore të rrjetës në

fjalë (20) për të përftuar tapetin përthithës njëpërdorimësh në fjalë (100) .
10. Procesi për prodhimin e një tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas pretendimit 9, i cili përfshin më tej hapat e: - sigurimit të shiritave alternativë (10) të materialit të papërshkueshëm nga lëngjet që ka një gjerësi më të madhe sesa gjerësia e zonave të lira tërthore në fjalë (24) përgjatë drejtimit të avancimit në fjalë (x) të rrjetës në fjalë (20) ; - vendosjes së secilit prej shiritave alternativë në fjalë (10) midis dy paneleve të njëpasnjëshme përthithëse me shumë shtresa (9) ; - prerjes në mënyrë tërthore të rrjetës në fjalë (20) në një vijë mesatare të shiritave alternativë në fjalë (10) për të përftuar shiritat në fjalë (4, 5) .
11. Procesi për prodhimin e një tapeti përthithës njëpërdorimësh (100) sipas pretendimit 9 ose 10, në të cilin hapat në fjalë të bashkimit së bashku të shtresave përthithëse në fjalë (1) dhe fletëve të materialit të përshkueshëm nga lëngjet në fjalë (3), të vendosjes së paneleve përthithëse me shumë shtresa në fjalë (9) mbi rrjetën në fjalë (20) të materialit të papërshkueshëm nga lëngjet dhe të vendosjes së shiritave në fjalë (4, 5, 10) përfshijnë hapat e ngjitjes ose saldimit së bashku të komponentëve në fjalë.

---

(11) **13766**
(97) EP4447453//03.06.2026
(96) 24197477.3//10.10.2017
(22) 26.08.2026
(21) AL/P/2026/520
(54) **MËNYRË DHE PAJISJE PËR KODIMIN/DEKODIMIN E TË DHËNAVE TË IMAZHIT**
19.10.2026
(30) KR KR 20160127893 04/10/2016, KR KR 20160129391 06/10/2016, KR KR 20170090621 17/07/2017
(71) B1 Institute of Image Technology, Inc./1213-ho, 525, Gonghangdae-ro
Gangseo-gu, Seoul 07563 / KR KO//

(72) Ki Beak KIM/Seogu, Daejeon 35206 / KR,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Një mënyrë për dekodimin e një imazhi 360-gradësh, ku mënyra përfshin: marrjen e një sekuence binare në të cilën është koduar imazhi 360-gradësh, sekuenca binare përfshin të dhëna të një imazhi dydimensional të zgjeruar (S1), ku imazhi dydimensional i zgjeruar përfshin një imazh dydimensional (S0) dhe një rajon të paracaktuar zgjerimi, ku imazhi dydimensional është projektuar nga një imazh me një strukturë projeksioni tredimensionale, dhe imazhi dydimensional përfshin të paktën një faqe (A) ; dhe rindërtimin e imazhit dydimensional të zgjeruar duke dekoduar të dhënat e imazhit dydimensional të zgjeruar, ku rindërtimi i imazhit dydimensional të zgjeruar përfshin marrjen e informacionit të mbetjes për një bllok të përfshirë në imazhin dydimensional të zgjeruar, i cili përfshin imazhin dydimensional dhe rajonin e paracaktuar të zgjerimit, karakterizuar në atë që: - madhësia e rajonit të zgjerimit përcaktohet bazuar në informacionin e parë të

gjerësisë (Exp_L) të rajonit të zgjerimit në anën e majtë të faqes dhe informacionin e dytë të gjerësisë (Exp_R) të rajonit të zgjerimit në anën e djathtë të faqes, ku si informacioni i parë i gjerësisë, ashtu edhe informacioni i dytë i gjerësisë merren nga sekuenca binare, - secili prej informacionit të parë të gjerësisë dhe informacionit të dytë të gjerësisë kufizohet për të treguar një numër çift mostrash të ndriçimit, në përputhje me formatin e ngjyrave të imazhit dydimensional, - vlerat e mostrave të rajonit të zgjerimit përcaktohen në përputhje me një mënyrë plotësimi, e cila përdor vlerat e mostrave të faqes, ku mënyra e plotësimit zgjidhet nga një pluralitet mënyrash plotësimi që përfshijnë një mënyrë plotësimi e cila modifikon vlerat e mostrave të faqes për vlerat e mostrave të rajonit të zgjerimit dhe - Mënyra e plotësimit për njërën anë të faqes përcaktohet ndryshe nga mënyra e plotësimit për anën tjetër të faqes.

2. Mënyra sipas pretendimit 1, ku mënyra e plotësimit zgjidhet nga pluraliteti i mënyrave të plotësimit bazuar në informacionin e përzgjedhjes të marrë nga sekuenca binare.

3. Një mënyrë për kodimin e një imazhi 360-gradësh, ku mënyra përfshin: përftimin e një imazhi dydimensional (S0) të projektuar nga një imazh me një strukturë projeksioni tredimensionale, ku imazhi dydimensional përfshin të paktën një faqe (A) ; përftimin e një imazhi dydimensional të zgjeruar (S1) që përfshin imazhin dydimensional dhe një rajon të paracaktuar zgjerimi; and kodimin e të dhënave të imazhit dydimensional të zgjeruar në një sekuencë binare në të cilin është koduar imazhi 360-gradësh, ku kodimi i të dhënave të imazhit dydimensional të zgjeruar përfshin marrjen e informacionit të mbetjes për një bllok të përfshirë në imazhin dydimensional të zgjeruar, i cili përfshin imazhin dydimensional dhe rajonin e paracaktuar të zgjerimit, karakterizuar në atë që: - madhësia e rajonit të zgjerimit kodohet bazuar në informacionin e parë të gjerësisë (Exp_L) të rajonit të zgjerimit në anën e majtë të faqes dhe informacionin e dytë të gjerësisë (Exp_R) të rajonit të zgjerimit në anën e djathtë të faqes, ku si informacioni i parë i gjerësisë, ashtu edhe informacioni i dytë i gjerësisë kodohen në sekuencën binare, - secili prej informacionit të parë të gjerësisë dhe informacionit të dytë të gjerësisë kufizohet të tregojë një numër çift mostrash të ndriçimit, në përputhje me formatin e ngjyrave të imazhit dydimensional, - vlerat e mostrave të rajonit të zgjerimit përcaktohen në përputhje me një mënyrë plotësimi, e cila përdor vlerat e mostrave të faqes, ku mënyra e plotësimit zgjidhet nga një pluralitet mënyrash plotësimi që përfshijnë një mënyrë plotësimi e cila modifikon vlerat e mostrave të faqes për të përcaktuar vlerat e mostrave të rajonit të zgjerimit dhe - mënyra e plotësimit për njërën anë të faqes përcaktohet ndryshe nga mënyra e plotësimit për anën tjetër të faqes.

4. Një mënyra për transmetimin e një sekunece binare, ku mënyra përfshin: përftimin e një imazhi dydimensional (S0) të projektuar nga një imazh me një strukturë projeksioni tredimensionale, ku imazhi dydimensional përfshin të paktën një faqe; përftimin e një imazhi dydimensional të zgjeruar (S1) që përfshin imazhin dydimensional dhe një rajon të paracaktuar zgjerimi; kodimin e të dhënave të imazhit dydimensional të zgjeruar në një sekuencë binare në të cilën është koduar imazhi 360-gradësh; dhe transmetimin e sekuencës binare ku kodimi i të dhënave të imazhit dydimensional të zgjeruar përfshin marrjen e informacionit të mbetjes për një bllok të përfshirë në imazhin dydimensional të zgjeruar, i cili përfshin imazhin dydimensional dhe rajonin e paracaktuar të zgjerimit, karakterizuar në atë

që: - madhësia e rajonit të zgjerimit kodohet bazuar në informacionin e parë të gjerësisë (Exp_L) të rajonit të zgjerimit në anën e majtë të faqes dhe informacionin e dytë të gjerësisë (Exp_R) të rajonit të zgjerimit në anën e djathtë të faqes, ku si informacioni i parë i gjerësisë, ashtu edhe informacioni i dytë i gjerësisë kodohen në sekuencën binare, - secili prej informacionit të parë të gjerësisë dhe informacionit të dytë të gjerësisë kufizohet për të treguar një numër çift mostrash të ndriçimit, në përputhje me formatin e ngjyrave të imazhit dydimensional, - vlerat e mostrave të rajonit të zgjerimit përcaktohen në përputhje me një mënyrë plotësimi e cila përdor vlerat e mostrave të faqes, ku mënyra e plotësimit zgjidhet nga një pluralitet mënyrash plotësimi që përfshijnë një mënyrë plotësimi e cila modifikon vlerat e mostrave të faqes për vlerat e mostrave të rajonit të zgjerimit dhe - mënyra e plotësimit për njërën anë të faqes përcaktohet ndryshe nga mënyra e plotësimit për anën tjetër të faqes.

---

(11) **13821**
(97) EP4403216//05.08.2026
(96) EP4403216//12.06.2013
(22) 27.08.2026
(21) AL/P/2026/521
(54) **PËRBËRJET TRICIKLIKE TË ZËVENDËSUARA SI FRENUES FGFR**
05.11.2026
(30) US US 201261659245 P 13/06/2012, US US 201261691463 P 21/08/2012, US US 201261740012 P 20/12/2012, US US 201361774841 P 08/03/2013
(71) Incyte Holdings Corporation/1801 Augustine Cut-Off
Wilmington, DE 19803 / US US//

(72) Liangxing WU/Wilmington, 19082 / US,
Colin ZHANG/Pennsylvania, 19002 / US,
Chunhong HE/Pennsylvania, 19317 / US,
Yaping SUN/Delaware, 19707 / US,
Liang LU/Delaware, 19707 / US,
Ding-Quan QIAN/Delaware, 19702 / US,
Meizhong XU/Delaware, 19707 / US,
Jincong ZHUO/Pennsylvania, 19060 / US,
Wenqing YAO/Pennsylvania, 19317 / US,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1.
Një përbërje e cila është zgjedhur si në vijim:
3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-8-(morfolin-4-ilmetil) -7-(fenilsulfonil) -1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2':5,6]pirido[4,3-d]pirimidin-2-one;
3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-2-okso-7-(fenilsulfonil) -2,3,4,7-tetrahidro-1H-pirrolo[3',2':5,6]pirido[4,3-d]pirimidine-8-karbaldehide;
3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-7-(fenilsulfonil) -1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2': 5,6]pirido[4,3-d]pirimidin-2-one;

3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2':5,6] pirido[4,3-d]pirimidin-2-one;
5-{[(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) amino]metil}-N-etil-1H-pirrolo[2,3-b]piridin-4-amine,
ose një kripë e ndonjërës prej të sipërpërmendurave.
2. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-8-(morfolin-4-ilmetil) -7-(fenilsulfonil) -1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2': 5,6]pirido[4,3-d]pirimidin-2-one, ose një kripë e saj.
3. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-8-(morfolin-4-ilmetil) -7-(fenilsulfonil) -1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2':5,6]pirido[4,3-d]pirimidin-2-one.
4. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-2-okso-7-(fenilsulfonil) -2,3,4,7-tetrahidro-1H-pirrolo[3',2': 5,6]pirido[4,3-d]pirimidine-8-karbaldehide, ose një kripë e saj.
5. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-2-okso-7-(fenilsulfonil) -2,3,4,7-tetrahidro-1H-pirrolo[3',2':5,6]pirido[4,3-d]pirimidine-8-karbaldehide.
6. Një përbërje e pretendimit 1, ku përbërja është 3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-7-(fenilsulfonil) -1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2':5,6]pirido[4,3-d]pirimidin-2-one, ose një kripë e saj.
7. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-7-(fenilsulfonil) -1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2':5,6]pirido[4,3-d]pirimidin-2-one.
8. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2':5,6] pirido[4,3-d]pirimidin-2-one, ose një kripë e saj.
9. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 3-(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) -1-etil-1,3,4,7-tetrahidro-2H-pirrolo[3',2':5,6] pirido[4,3-d]pirimidin-2-one.
10. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 5-{[(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) amino]metil}-N-etil-1H-pirrolo[2,3-b]piridin-4-amine, ose një kripë e saj.
11. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja është 5-{[(2,6-difluoro-3,5-dimetoksifenil) amino]metil}-N-etil-1H-pirrolo[2,3-b]piridin-4-amine.


---

(11) **13822**
(97) EP4568957//15.07.2026
(96) 24782667.0//30.08.2024
(22) 28.08.2026
(21) AL/P/2026/522
(54) **PËRBËRJET E ZËVENDËSUARA TË FENIL OKSOOKSAZOLIL PIPERIDINE DIONE**
05.11.2026
(30) IN IN202311058935 02/09/2023
(71) Bristol-Myers Squibb Company/Route 206 and Province Line Road
Princeton, NJ 08543 / US US//

(72) Pravin Sudhakar SHIRUDE/Bangalore 560099 / IN,


Suresh Babu Vishwa Krishna PENMETSA/Bangalore 560099 / IN,
Bharat Dinkar SHIMPUKADE/Bangalore 560099 / IN,
Emily Charlotte CHERNEY/Princeton, New Jersey 08543 / US,
Durgarao KANTHETI/Bangalore 560099 / IN,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË


(57) 1. Një përbërje e Formulës (I) :



(I)


ose stereoizomere, tautomere ose kripëra të tyre, ku:
R është:






ose


2. Përbërja sipas pretendimit 1, ose stereoizomere, tautomere ose kripëra të saj, ku përbërja e sipërpërmendur është:




3. Përbërja sipas pretendimit 1, ose stereoizomere, tautomere ose kripëra të saj, ku përbërja e sipërpërmendur është:




4. Përbërja sipas pretendimit 1, ose stereoizomere, tautomere ose kripëra të saj, ku përbërja e sipërpërmendur është:



5. Përbërja sipas pretendimit 1, ose stereoizomere, tautomere ose kripëra të saj, ku përbërja e sipërpërmendur është:



6. Përbërja sipas pretendimit 1, ose stereoizomere, tautomere ose kripëra të saj, ku përbërja e sipërpërmendur është:



7. Një kompozim farmaceutik që përfshin një përbërje sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 6, ose stereoizomere, tautomere ose kripëra farmaceutikisht të pranueshme të tyre; dhe një bartës farmaceutikisht të pranueshëm.

8. Një përbërje, ose stereoizomerë, tautomerë, ose kripëra farmaceutikisht të pranueshme të tyre, sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 6 për përdorim në trajtimin e kancerit.

9. Përbërja, ose stereoizomerët, tautomerët, ose kripërat farmaceutikisht të pranueshme të tyre, për përdorim sipas pretendimit 8, ku kanceri i sipërpërmendur është zgjedhur nga kanceri i zorrës së trashë, kanceri gastrik, kanceri pankreatik, kanceri i gjirit, kanceri i prostatës, kanceri i mushkërive, kanceri ovarian, kanceri i qafës së mitrës, kanceri i veshkave, kanceri i kokës dhe qafës, limfoma, leuçemia dhe melanoma.

10. Përbërja, ose stereoizomerët, tautomerët, ose kripërat farmaceutikisht të pranueshme të tyre, për përdorim sipas pretendimit 9 në kombinim me një agjent të dytë, ku agjenti i dytë i sipërpërmendur është zgjedhur nga një antagonist i boshtit PD1/PD-L1, një antagonist i CTLA4, një agjent kimioterapeutik, rrezatim ose një vaksinë antitumorale.

11.

Një përbërje, ose një stereoizomer, një tautomer, ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tyre sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 6 për përdorim në një metodë të trajtimit të kancerit, ku metoda përfshin uljen e niveleve të proteinave Ikaros, Helios, Aiolos dhe Eos në qeliza duke kontaktuar qelizat e sipërpërmendura me përbërjen e sipërpërmendur, ose një stereoizomer, një tautomer, ose një kripë farmaceutikisht të pranueshme të tyre, ku

a) niveli i proteinës Ikaros ulet me të paktën 30%;

b) niveli i proteinës Helios ulet me të paktën 50%;

c) niveli i proteinës Aiolos ulet me të paktën 30%; dhe

d) niveli i proteinës Eos ulet me të paktën 50%.

(97) EP3541422//01.07.2026
(96) 17872021.5//15.11.2017
(22) 28.08.2026
(21) AL/P/2026/523
(54) **ANTITRUP SPECIFIK ANTI-IL-23 GUSELKUMAB PËR PËRDORIM NË TRAJTIMIN E PSORIAZËS**
05.11.2026
(30) US US 201662422891 P 16/11/2016
(71) Janssen Biotech, Inc./800/850 Ridgeview Drive
Horsham, PA 19044 / US US//

(72) Dennis FITZGERALD/1400 McKean Road Spring House, Pennsylvania 19477 / US,
Jay SIEGAL/4501 Leland Street Chevy Chase, Maryland 20815 / US,
Newman YEILDING/1400 McKean Road Spring House, Pennsylvania 19477 / US,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Një antitrup specifik anti-IL-23 për përdorim në një metodë të trajtimit të psoriazës tek një pacient i trajtuar me një antitrup ndaj IL-12/23p40 dhe i përcaktuar të jetë një përgjigje joadekuate ndaj trajtimit me antitrupa IL-12/23p40, ku metoda përfshin: matja nëse një pacient i trajtuar me një antitrup IL-12/23p40 është një përgjigje joadekuate duke matur një rezultat IGA ose PGA, dhe/ose PASI tek pacienti; përcaktimi që një pacient nuk i përgjigjet në mënyrë të mjaftueshme trajtimit me antitrupa IL-12/23p40 nga hapi i matjes, ku pacienti përcaktohet të jetë një përgjigje joadekuate ndaj trajtimit me antitrupa IL-12/23p40 nga një rezultat IGA ose PGA më i madh ose i barabartë me 2, ose një përmirësim i rezultatit PASI më pak se 75% krahasuar me rezultatin bazë PASI para trajtimit; dhe administrimi i pacientit të përcaktuar si një përgjigje joadekuate ndaj trajtimit me antitrupa IL-12/23p40, një antitrup specifik anti-IL-23 në një sasi të sigurt dhe efektive, ku: antitrupi specifik anti-IL-23 është guselkumab; antitrupi specifik anti-IL-23 administrohet nën-lëkurë në një dozë prej 100 mg të administruar në një dozë fillestare, 4 javë pas dozës fillestare dhe çdo 8 javë pas dozës në 4 javë; pacienti është një përgjigje ndaj antitrupit specifik anti-IL-23 dhe identifikohet se ka një PASI90 ose më të lartë; dhe Antitrupi IL-12/23p40 është ustekinumab.
2. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas pretendimit 1, ku pacienti është një përgjigje ndaj antitrupit specifik anti-IL-23 dhe identifikohet si person që ka një rezultat PASI100 ose më të madh ose PGA 0 ose 1 ose përmirësim IGA prej të paktën 2.
3. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas pretendimit 1 ose 2, ku rezultati PASI90, PASI100, IGA 0 ose 1 ose përmirësimi IGA prej të paktën 2 matet 16, 20 ose 28 javë pas trajtimit fillestar.
4. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve 1-3, ku pacienti përcaktohet të jetë një përgjigje joadekuate ndaj trajtimit me antitrup IL-12/23p40 nga një përmirësim i pikëve PASI prej më pak se 75% krahasuar me pikët bazë PASI para trajtimit.
5. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve 1-4, ku psoriaza është psoriazë e tipit pllakë e moderuar deri në të rëndë, ku pacienti

është opsionalisht një kandidat për fototerapi ose trajtim sistemik për psoriazën.
6. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-5, ku antitrupi specifik anti-IL-23 është i sigurt dhe efektiv në trajtimin e psoriazës në një zonë të një pacienti të zgjedhur nga grupi që përbëhet nga skalpi, thonjtë, duart dhe këmbët.
7. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-6, ku antitrupi specifik anti-IL-23 është në një përbërje që përmban 100 mg/mL antitrup; 7,9% (p/v) sukrozë, 4,0 mM histidinë, 6,9 mM L-Histidinë monohidroklorur monohidrat; 0,053% (p/v) polisorbat 80 të përbërjes farmaceutike; ku holluesi është ujë në gjendje standarde.
8. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-7, ku metoda përfshin më tej administrimin tek pacienti të një ose më shumë barnave shtesë të përdorura për të trajtuar psoriazën.
9. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas pretendimit 8, ku ilaçi shtesë zgjidhet nga grupi që përbëhet nga: agjentë imunosupresivë, ilaçe anti-inflamatore jo-steroide (NSAID), metotreksat (MTX), antitrupa shënues sipërfaqësorë anti-qelizash B, antitrupa anti-CD20, rituximab, frenues të TNF, kortikosteroide dhe modifikues bashkë-stimulues.
10. Antitrupi specifik anti-IL-23 për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve 1-9, ku antitrupi specifik anti-IL-23 është efektiv për të zvogëluar një simptomë të psoriazës tek pacienti, për të shkaktuar përgjigje klinike, për të shkaktuar ose ruajtur remisionin klinik, për të penguar përparimin e sëmundjes ose për të penguar një ndërlikim të sëmundjes tek pacienti.

---

(11) **13824**
(97) EP3693219//01.07.2026
(96) 18826755.3//13.08.2018
(22) 28.08.2026
(21) AL/P/2026/524
(54) **SISTEM SPECIFIK SINJALIZIMI PËR PARALAJMËRIMIN E PËRDORUESVE TË RRUGËS PËR HAPJEN E AFËRT TË DYERËVE TË AUTOMJETIT**
05.11.2026
(30) ES ES20170000652U 26/09/2017
(71) Ricardo YAGÜE HERNÁNZ/Calle Santiago de Compostela, 48
28034 Madrid, ES ES; Maria Nieves Yagüe Hernánz/Calle Santiago de Compostela 48
28034 Madrid, ES ES//

(72) Ricardo YAGÜE HERNÁNZ/Calle Santiago de Compostela, 48 28034 Madrid / ES,
Maria Nieves Yagüe Hernánz/Calle Santiago de Compostela, 48 28034 Madrid / ES,
(74) P E T O S E V I C //
Rruga Fadil Rada, Pallati Gener 2, Shkalla C, Nr 2/1, Tirane
(57) 1.
Sistem sinjalizimi për një automjet me rripa sigurie dhe pasqyra të jashtme në anën e shoferit dhe pasagjerit për të paralajmëruar përdoruesit e rrugës për një hapje të afërt të një dere (4) të anës së shoferit ose pasagjerit të automjetit para se të

ndodhë një hapje e tillë, ku sistemi përfshin:
- dy pasqyra të jashtme (1) që do të instalohen secila përkatësisht në anët e shoferit dhe pasagjerit të automjetit,
- një grup dritash paralajmëruese të fuqishme (2R / 2N) të instaluara rreth gjithë perimetrit të secilës prej pasqyrave të jashtme (1) të automjetit në anën pasqyrë të pasqyrave të jashtme, ku grupet e dritave paralajmëruese të fuqishme janë të orientuara për të lëshuar dritë horizontalisht, dhe jo poshtë ose drejt tokës, kur sistemi i sinjalizimit është i instaluar në automjet, dhe për këtë arsye të dukshme në drejtimin horizontal për përdoruesit e rrugës në distancë nga automjeti,
- një numër sensorësh pranie (7) që janë të lidhur me grupet e dritave paralajmëruese të fuqishme (2R / 2N) dhe që duhet të instalohen në dorezat e brendshme (6) të secilës prej dyerve (4), ku secili sensor pranie (7) i shumësisë së sensorëve të pranisë është i konfiguruar për të zbuluar dorën e një pasagjeri të automjetit përpara se dora të prekë një dorezë të brendshme (6), dhe në këtë mënyrë para funksionimit të dorezës përkatëse të brendshme (6) nga dora e pasagjerit për të hapur derën e lidhur me dorezën e brendshme dhe për të dalë nga automjeti, dhe
- një numër sensorësh të ankorimit të rripit të sigurisë të lidhur me shumësinë e sensorëve të pranisë dhe grupet e dritave paralajmëruese të fuqishme, ku sensorët e ankorimit të rripit të sigurisë janë të konfiguruar për të zbuluar lirimin e rripave të sigurisë, ku sistemi është gjithmonë aktiv në automjet dhe është konfiguruar në mënyrë të tillë që kur një sensor i parë i pranisë, në anën e shoferit ose pasagjerit, zbulon një dorë pasagjeri që afrohet dhe një sensor i parë i ankorimit të rripit të sigurisë i lidhur me një rrip sigurie në të njëjtën anë të shoferit ose pasagjerit si sensori i parë i pranisë zbulon se rripi i sigurisë lirohet, grupi i dritave të fuqishme paralajmëruese (2R / 2N) i lidhur me pasqyrën e jashtme (1) në të njëjtën anë të shoferit ose pasagjerit të automjetit si sensori i parë i pranisë që zbuloi dorën që afrohej, aktivizohet në një modalitet pulsimi për të dhënë paralajmërim përdoruesve të rrugës për hapjen e afërt të një dere të automjetit në anën përkatëse të shoferit ose pasagjerit të automjetit,

ku kur aktivizohen grupet e dritave të fuqishme paralajmëruese (2R / 2N), grupi i dritave të fuqishme paralajmëruese (2R / 2N) lëshon një shkëlqim të lartë dhe dallohen nga përdoruesit e rrugës në një distancë në drejtimin horizontal të barabartë ose më të madhe se ajo e dritave të tjera sinjalizuese ose treguese të automjetit.

---

(11) **13798**
(97) EP4298158//05.08.2026
(96) 22711091.3//24.02.2022
(22) 01.09.2026
(21) AL/P/2026/529
(54) **PROCES PËR PRODHIMIN E BIS(2-HIDROKSIETIL) TEREFTALATIT NË FORMË TË LËNGSHME NËPËRMJET DEPOLIMERIZIMIT TË POLIETILEN TEREFTALATIT (PET)**
27.10.2026
(30) IT IT202100004286 24/02/2021

(71) ChemPET S.r.l./Via Prati Nuovi 9
28065 Cerano (NO) / IT IT//

(72) Guido FRAGIACOMO/28100 Novara (NO) / IT,
Gabriele NIPOTI/27020 Tromello (PV) / IT,
Gianluigi NOJA/28100 Novara (NO) / IT,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Proces për prodhimin e bis(2-hidroksietil) tereftalatit (BHET) në formë të lëngshme nëpërmjet depolimerizimit të polietilen tereftalatit (PET), i cili përfshin: (a) depolimerizimin e PET-it nëpërmjet glikolizës me monoetilen glikol (MEG), për të përftuar një tretësirë të papërpunuar të BHET-it; (b) pastrimin e tretësirës së papërpunuar të BHET-it për të përftuar një tretësirë të pastruar të BHET-it; (c) ftohjen e tretësirës së pastruar të BHET-it për ta kristalizuar atë, në mënyrë që të përftohet BHET në formë kristalore të ngopur me një tretës; (d) përgatitjen, nëpërmjet shkrirjes së BHET-it në formë kristalore të përftuar në hapin (c), të një tretësire të BHET-it në tretës në një temperaturë më të ulët ose të barabartë me 90 °C dhe më të lartë ose të barabartë me 70 °C, duke rregulluar, nëse është e nevojshme, përmbajtjen e tretësit në tretësirën e BHET-it të përftuar në këtë mënyrë në një vlerë të tillë që të përftohet një temperaturë shkrirjeje e BHET-it brenda kufijve të treguar më sipër; ku tretësi është ujë dhe sasia e ujit, e tillë që të përftohet një temperaturë shkrirjeje e kristaleve të BHET-it të ngopura me ujë nga 70 °C deri në 90 °C, është nga 12 % deri në 20 % ndaj peshës, në raport me peshën totale të përzierjes së BHET-it dhe tretësit; ose ku tretësi është një përzierje e ujit dhe MEG-it në një raport në peshë ujë/MEG nga 0,5 deri në 2, dhe sasia e përzierjes së ujit dhe MEG-it, e tillë që të përftohet një temperaturë shkrirjeje e kristaleve të BHET-it të ngopura me ujë nga 70 °C deri në 90 °C, është nga 15 % deri në 30 % ndaj peshës, në raport me peshën totale të përzierjes së BHET-it dhe tretësit.
2. Proces sipas pretendimit 1, ku BHET-i në formë të lëngshme i përftuar në fund të procesit përmban një sasi të grupeve karboksilike të lira (CEG), të matur sipas standardit ASTM D7409-15, nga 40 deri në 100 mmol/kg, mundësisht nga 60 deri në 80 mmol/kg.
3. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku BHET-i në formë të lëngshme i përftuar në fund të procesit ka një numër aciditeti, të matur sipas standardit ASTM D1613-17, nga 2 deri në 6 mg KOH/g, mundësisht nga 3 deri në 5 mg KOH/g.
4. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hapi (a) i depolimerizimit të PET-it nëpërmjet glikolizës me monoetilen glikol (MEG) kryhet me PET të ricikluar, të përftuar nga rikuperimi i mbetjeve pas konsumit dhe/ose mbetjeve post-industriale.
5. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hapi i pastrimit (b) përfshin një hap filtrimi për ndarjen e ndotësve të patretshëm dhe, sipas dëshirës, një hap për heqjen e ndotësve të tretshëm me anë të një agjenti absorbues ose nëpërmjet oksidimit dhe trajtimit të mëvonshëm me një agjent absorbues.
6. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku në përfundim të

hapit të kristalizimit (c), BHET-i në formë kristalore është i ngopur me një sasi tretësi nga 15 % deri në 50 % ndaj peshës, mundësisht nga 20 % deri në 40 % ndaj peshës, në raport me peshën totale të BHET-it dhe tretësit.
7. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hapi i shkrirjes (d) kryhet duke ngrohur BHET-in në një temperaturë që varion nga 80 °C deri në 85 °C.
8. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku, në rast se në përfundim të hapit të shkrirjes (d) sasia e tretësit është tepër e lartë, përmbajtja e tretësit rregullohet nëpërmjet avullimit të tretësit derisa BHET-i të përftohet në formë të lëngshme në një temperaturë më të ulët ose të barabartë me 90 °C dhe më të lartë ose të barabartë me 70 °C.
9. Proces sipas cilitdo prej pretendimeve 1 deri në 7, ku, në rast se në përfundim të hapit të shkrirjes (d) sasia e tretësit është tepër e ulët, përmbajtja e tretësit rregullohet nëpërmjet shtimit të tretësit derisa BHET-i të përftohet në formë të lëngshme në një temperaturë më të ulët ose të barabartë me 90 °C dhe më të lartë ose të barabartë me 70 °C.
10. Proces për prodhimin e polietilen tereftalatit (PET), i cili përfshin: prodhimin e bis(2-hidroksietil) tereftalatit (BHET) në formë të lëngshme nëpërmjet depolimerizimit të polietilen tereftalatit (PET) të ricikluar, me anë të një procesi sipas cilitdo prej pretendimeve të mësipërme; përdorimin e BHET-it të sipërpërmendur si monomeri kryesor për prodhimin e PET-it nëpërmjet polikondensimit, ose si monomer dytësor në një proces polikondensimi të acidit tereftalik (TPA) dhe monoetilen glikolit (MEG) .

---

(11) **13826**
(97) EP4288549//03.06.2026
(96) 22763678.4//05.03.2022
(22) 02.09.2026
(21) AL/P/2026/533
(54) **ACID NUKLEIK I OPTIMIZUAR PËR KODON QË KODON PROTEINËN FIKSE**
05.11.2026
(30) RU RU 2021105703 05/03/2021
(71) Joint Stock Company "Biocad"/Joint Stock Company "Biocad"
vn. ter. g. poselok Strelna
ul. Svyazi, d. 38, str. 1, pomeshch. 89
198515 Saint Petersburg / RU RU//

(72) Alexander Vladimirovich PROKOFYEV/Saint Petersburg, 198206 / RU,
Pavel Mikhailovich GERSHOVICH/Saint Petersburg, 198328 / RU,
Anna Nikolaevna STRELKOVA/Yaransk, 612261 / RU,
Natalia Aleksandrovna SPIRINA/Saint Petersburg, 192283 / RU,
Tatiana Evgenievna SHUGAEVA/Moscow, 119021 / RU,
Dmitry Valentinovich MOROZOV/Saint Petersburg, 190000 / RU,
(74) Krenar Loloçi//

ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË

(57) 1. Një acid nukleik i izoluar, i optimizuar për kodonet, që kodon proteinën FIX (faktori i koagulimit IX) që ka sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 1, që përfshin një sekuencë nukleotidesh të zgjedhur nga grupi që përfshin: SEQ ID NO: 2 ose SEQ ID NO: 4.

2. Një kasetë shprehjeje që përmban acidin nukleik të optimizuar për kodonin sipas pretendimit 1.

3. Kasetë shprehjeje sipas pretendimit 2, që përfshin elementët e mëposhtëm në drejtim nga skaji 5' në skajin 3': një ITR i majtë (i pari) (përsëritje terminale të përmbysura) ; Promotori TTR (promotori i transtiretinës) ; një intron i gjenit hBG1 (një fragment i gjenit β-globinë njerëzor që përmban intron) ; acidi nukleik i optimizuar për kodon sipas pretendimit 1; një sinjal poliadenilimi i hGH1 (sinjal poliadenilimi i gjenit të hormonit të rritjes njerëzore) ; një ITR i djathtë (i dyti) .

4. Kasetë shprehjeje sipas pretendimit 3, që përfshin një sekuencë nukleotidesh të zgjedhur nga grupi që përfshin: SEQ ID NO: 3 ose SEQ ID NO: 5.

5. Një vektor shprehjeje që përfshin acidin nukleik të optimizuar për kodon sipas pretendimit 1 ose kasetën e shprehjes sipas secilit prej pretendimeve nga 2 deri në

6. Virus rekombinant i izoluar bazuar në AAV5 (serotipi 5 i virusit të lidhur me adeno) për rritjen e shprehjes së gjenit FIX në qelizat shënjestër, që përfshin acidin nukleik të optimizuar për kodon sipas pretendimit 1 ose kasetën e shprehjes sipas secilit prej pretendimeve 2 deri në 4.

7. Virusi rekombinant i bazuar në AAV5 sipas pretendimit 6, ku kapsidi përfshin proteinën AAV5 VP1, mundësisht (i) ku kapsidi përfshin proteinën AAV5 VP1 që ka sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 11 ose (ii) ku kapsidi përfshin proteinën AAV5 VP1 që ka sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 11 me një ose më shumë mutacione pikësore, mundësisht ku kapsidi përfshin proteinën AAV5 VP1 që ka sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 14.

8. Virus rekombinant me bazë AAV5 sipas secilit prej pretendimeve 6 ose 7, ku kapsidi përfshin proteinën AAV5 VP1 që ka sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 11 ose sekuencë aminoacide e SEQ ID NO: 11 me një ose më shumë mutacione pikësore, dhe kaseta e shprehjes përfshin elementët e mëposhtëm në drejtim nga skaji 5' në skajin 3': një ITR i majtë (i pari) (përsëritje terminale të përmbysura) ; një promotor TTR një intron i gjenit hBG1 (një fragment i gjenit β-globinë njerëzor që përmban intron) ; acidi nukleik i optimizuar për kodon sipas pretendimit 1; një sinjal poliadenilimi i hGH1 (sinjal poliadenilimi i gjenit të hormonit të rritjes njerëzore) ; një ITR i djathtë (i dyti) .

9. Virus rekombinant me bazë AAV5 sipas pretendimit 8, ku kapsidi përfshin proteinën AAV5 VP1 që ka sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 11 ose sekuencë aminoacide e SEQ ID NO: 11 me një ose më shumë mutacione pikësore, dhe kaseta e shprehjes përfshin një sekuencë nukleotidesh të zgjedhur nga grupi që përfshin SEQ ID NO: 3 ose SEQ ID NO: 5.

10. Virus rekombinant me bazë AAV5 sipas pretendimit 8 ose 9, ku proteina AAV5 VP1 ka sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 11 me një ose më shumë mutacione pikësore është sekuenca aminoacide e SEQ ID NO: 14.

11. Përbërje farmaceutike për transferimin e gjenit FIX në qelizat shënjestër, që përfshin virusin rekombinant të bazuar në AAV5 sipas secilit prej pretendimeve 6

deri në 10, në kombinim me një ose më shumë eksipientë farmaceutikisht të pranueshëm.
12. Përdorimi in vitro i virusit rekombinant me bazë AAV5 sipas pretendimeve 6 deri në 10 ose i përbërjes sipas pretendimit 11 për transferimin e gjenit FIX në qelizat shënjestër.
13. Virusi rekombinant i bazuar në AAV5 sipas secilit prej pretendimeve 6 deri në 10 ose përbërja sipas pretendimit 11, e destinuar për përdorim në trajtimin e një subjekti me hemofili B dhe/ose që i mungojnë kopje plotësisht funksionale të gjenit FIX, ku virusi rekombinant i bazuar në AAV5 ia jep proteinën FIX subjektit.
14. Virus rekombinant me bazë AAV5 sipas secilit prej pretendimeve 6 deri në 10 ose përbërja sipas pretendimit 11, për përdorim në trajtimin e hemofilisë B tek një subjekt i prekur nga hemofilia B.

---

(11) **13827**
(97) EP4139383//05.08.2026
(96) 21726188.2//20.04.2021
(22) 02.09.2026
(21) AL/P/2026/534
(54) **PROCES PËR DEPOLIMERIZIMIN E POLIETILENI TEREFTALATI (PET) ME ANË TË GLIKOLIZËS ME ETILEN GLIKOL, DHE IMPIANT PËR KRYERJEN E TË NJËJTËS**
05.11.2026
(30) IT IT202000008935 24/04/2020
(71) ChemPET S.r.l./Via Prati Nuovi 9
28065 Cerano (NO) / IT IT//

(72) Guido FRAGIACOMO/Viale Giuseppe Verdi, 18 28100 NOVARA / IT,
Gianluigi NOJA/Via Lagrange, 30 28100 NOVARA / IT,
Devis Luigi MAZZUCCO/Via Morsella, 7/B 27029 Vigevano (PV) / IT,
Marco CASAROTTI/Via della Costituzione 28066 Galliate (NO) / IT,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Procesi për depolimerizimin e një polietileni tereftalati (PET) me anë të glikolizës me etilen glikol (EG), i cili përfshin: (a) përzierjen e PET në gjendje të ngurtë me një sasi EG të tillë që të përftohet një raport peshe EG:PET (R0) nga 0.2 në 4.0, në një temperaturë nga 60°C në 120°C, dhe shtypjen e përzierjes heterogjene të përftuar për të shtrydhur një alikuot të EG në mënyrë që të përftohet përzierja heterogjene me një raport peshe EG:PET (R1) nga 0.1 në 3.0; (b) ushqimin e përzierjes heterogjene të përmendur në një blender ku përzierja nxehet dhe mbahet nën përzierje në një temperaturë nga 170°C në 270°C me një raport peshe EG:PET (R2) nga 0.1 në 4.0, në mënyrë që të glikolizojë PET dhe të përftohet një produkt i glikolizuar që përmban bis(2-hidroksietil) tereftalat (BHET) dhe/ose oligomerë të tij.
2. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hapi (a) kryhet në një presë vidë, preferimisht në një presë vidë të vendosur në një konfigurim të

pjerrët, domethënë, me aksin e zhvillimit të vidës të pjerrët në lidhje me planin horizontal.
3. Proces sipas pretendimit 1 ose 2, ku hapi (a) ndahet në dy hapa (a1) dhe (a2), të kryera në dy pajisje të ndryshme: hapi (a1) i përzierjes së PET në gjendje të ngurtë me EG, në një temperaturë nga 60°C deri në 120°C, për të përftuar përzierjen heterogjene, hapi (a1) i përmendur kryhet në një blender; hapi (a2) i kompresimit të përzierjes heterogjene të përftuar në hapin (a1) i cili lejon shtrydhjen e një alikuoti të EG nga e njëjta përzierje, në mënyrë që të përftohet përzierja heterogjene me një raport peshe EG:PET (R1) nga 0.1 në 3.0, hapi (a2) i përmendur kryhet në një presë vidë.
4. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku përzierja heterogjene transferohet nga hapi (a) në hapin (b) duke kaluar nëpër një qelizë transferuese e cila mbledh një sasi të paracaktuar të përzierjes heterogjene që del nga hapi (a) dhe e transferon të njëjtën në hapin (b) me anë graviteti.
5. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hapi (b) kryhet në një atmosferë inerte.
6. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku BHET dhe/ose oligomerët e tij ushqehen në hapin (b), opsionalisht të rikuperuara gjatë hapave pasues të procesit.
7. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hapi (b) kryhet në një reaktor pedalues.
8. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku në fund të hapit (a) përzierja heterogjene ka një përmbajtje uji të barabartë ose më të ulët se 0.5% të peshës, në lidhje me peshën e PET-it.
9. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, i cili përfshin më tej një hap filtrimi të produktit të glikolizuar të marrë nga hapi (b) .
10. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, i cili përfshin më tej nënshtrimin e produktit të glikolizuar që rezulton nga hapi (b) në një hap të mëtejshëm të glikolizës (c), me një raport peshe EG:PET (R4) nga 0.5 në 10.0.
11. Proces sipas pretendimit 10, ku hapi i mëtejshëm i glikolizës (c) kryhet në një numër reaktorësh depozitë përzierjeje, të vendosur në seri për të formuar një reaktor shumëfazësh që funksionon vazhdimisht.
12. Proces sipas çdonjërit prej pretendimeve të mëparshëm, ku produkti i glikolizuar që lë hapin (b) ose hapin (c) i nënshtrohet një hapi për ndarjen e materialeve të mundshme huaja të ngurta, që kanë një dendësi më të ulët se produkti i glikolizuar, të cilat hiqen nga sipërfaqja e produktit të glikolizuar.

---

(11) **13791**
(97) EP4233853//19.08.2026
(96) 23164354.5//30.09.2016
(22) 03.09.2026
(21) AL/P/2026/538
(54) **ADELMIDROL PËR PËRDORIM NË TRAJTIMIN E KONDROPATIVE ARTIKULARE**
26.10.2026
(30) IT IT UB20154849 30/10/2025

(71) EPITECH GROUP S.p.A./Via Egadi 7
20144 Milano (MI) / IT IT//

(72) Francesco DELLA VALLE/deceased / IT,
Maria Federica DELLA VALLE/I-20144 Milan / IT,
Salvatore CUZZOCREA/I-20144 Milan / IT,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Adelmidrol për përdorim në trajtimin e sëmundjeve të ndjeshme ndaj agonizmit specifik të receptorit PPAR-gama tek njerëzit ose kafshët ku sëmundjet e sipërpërmendura janë kondropati artikulare dhe ku Adelmidrol i sipërpërmendur është formuluar në një formulim për administrim parenteral me injeksion për infiltrim në një nyje, ku Adelmidrol përmbahet në formulimet e sipërpërmendura në një dozë nga 1 mg deri në 7 g për administrim tek një njeri me një peshë trupore prej rreth 70 kg ose nga 10 mg deri në 700 mg të përbërësit aktiv për njësi doze.
2. Adelmidrol për përdorim sipas pretendimit 1, ku sëmundjet e sipërpërmendura janë: kondropatitë artikulare me origjinë mekanike, toksike, jatrogjenike, degjenerative ose të shoqëruara me fenomene inflamatore kryesisht të lidhura me organe dhe inde që nuk i përkasin sistemit osteoartikular; fibrogjeneza e kërceve artikulare.
3. Adelmidrol për përdorim sipas pretendimit 1 ose 2, formula e sipërpërmendur përbëhet nga: - Adelmidrol 40 mg - Kripë natriumi e acidit hialuronik 20 mg - Tretës izosmotik i tamponuar në pH 7.0 q.s. deri në 5 mL.

---

(11) **13807**
(97) EP4055496//10.06.2026
(96) 20883786.4//09.11.2020
(22) 09.09.2026
(21) AL/P/2026/548
(54) **METODA, CRMS DHE SISTEME PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, SHIKIMIN DHE LIDHJEN E ANOTACIONEVE**
28.10.2026
(30) US US201916679285 10/11/2019, US US201916679278 10/11/2019
(71) ExactNote, Inc./8 The Green, STE B Dover, DE 19901 / US US//

(72) Rona SFAKIANAKIS/Rona Sfakianakis, ExactNote, Inc. Suite 210-A, 300 Delaware Ave Wilmington, Delaware 19801 / US,
Sunil PINNAMANENI/Sunil Pinnamaneni, ExactNote, Inc., Suite 210-A, 300 Delaware Avenue Wilmington, Delaware 19801 / US,
(74) Gazmir Isakaj//
MIhal Grameno; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Tiranë 2; 0000; Tiranë, TIRANË, Tiranë
(57) 1. Një metodë për krijimin e një turi të udhëzuar përmes një serie seti faqesh web në Internetin global, duke tërhequr vëmendjen e përdoruesit në pikat kryesore të interesit në secilin set faqesh web, metoda e ekzekutuar në një arkitekturë

klient-server që përfshin një server anotacioni (61), një bazë të dhënash elektronike (62) dhe të paktën një pajisje klienti në të cilën funksionon një shfletues web (161) i aftë për anotacione, karakterizuar nga hapa që përfshijnë: marrjen nga serveri të anatocionit (61) nga shfletuesi web i aftë për anotacione (24) një udhëzim krijimi (167) për të krijuar një bllok shënimesh që përfshin një listë referencash për objektet e anotimit (223) të ruajtura tashmë, duke përdorur bazën e të dhënave elektronike (62), ku një objekt anotimi përfshin: një Uniform Resource Locator, i referuar më poshtë si URL, për një dokument (64) që përfshin një faqe web ose një dokument PDF dhe të përfaqësuar nga një strukturë DOM; një element të dhënash për përfaqësimin e një pjese të zgjedhur teksti nga dokumenti (27, 38), ku pjesa e zgjedhur e tekstit është përfaqësuese e një objekti anotimi; një informacion për gjetjen e pjesës së zgjedhur të tekstit në dokumentin e paraqitur në shfletuesin web (24) të aftë për anotim, informacion që përfshin informacionin DOM; dhe një grup prej një ose më shumë pamjesh ekrani të dorëzueshme, ku një pamje ekrani e dorëzueshme korrespondon me një pamje ekrani të shënuar (37) në një grup ruajtjeje, dhe ku pamja e ekranit e dorëzueshme (176) përfshin një përzgjedhje të paracaktuar nga një grup që përfshin: vetë pamjen e shënuar (37) të ekranit; dhe një URL për marrjen e pamjes së ekranit të shënuar (193) nga një Rrjet i Shpërndarjes së Përmbajtjes, i referuar më poshtë si CDN, (63), ku grupi i ruajtjes përfshin një ose më shumë pamje të ekranit të shënuara të krijuara nga një pamje fillestare e ekranit e shënuar që përfshin një pjesë të dokumentit që tregon pjesën e zgjedhur të tekstit (37), dhe ku pjesa e zgjedhur e tekstit është e shënuar vizualisht (37) ; krijimin e objektit të bllokut të shënimeve nga serveri të anatocionit (61) duke dërguar udhëzime (168) për të krijuar objektin e bllokut të shënimeve në bazën e të dhënave elektronike (62) ;; marrjen nga serveri të anatocionit (61) nga shfletuesi web i aftë për shënime (24) një udhëzim shtimi (181) për të shtuar një referencë në objektin e anotacionit në listën e referencave për objektet e anotimit të bllokut të shënimeve, serveri të anatocionit (61) dërgon një udhëzim shtimi (182) në bazën e të dhënave elektronike (62) ; dhe ruajtjen e objektit të bllokut të shënimeve që korrespondon me bllokun e shënimeve në bazën e të dhënave elektronike (62) pas marrjes së udhëzimeve përkatëse të shtimit nga serveri të anatocionit (61), ku objekti i bllokut të shënimeve përbëhet nga lista e referencave për objektet e anotimit të bllokut të shënimeve

2. Metoda e pretendimit 1, ku një pamje e shënuar e ekranit në grupin e ruajtjes është një pamje e shënuar e ekranit (37) në miniaturë

3. Metoda e pretendimit 1 ose 2, ku lista e referencave për objektet e anotacioneve (223) është fillimisht bosh

4. Metoda e njërit prej pretendimeve të mëparshme, që përfshin më tej hapat e marrjes së një udhëzimi fshirjeje për të hequr një referencë në listën e referencave për objektet e shënimeve të bllokut të shënimeve duke përdorur një ose më shumë sisteme kompjuterike dhe përditësimin e objektit të bllokut të shënimeve në bazën e të dhënave elektronike për të reflektuar ndryshimin e shkaktuar nga udhëzimi i fshirjes

5. Metoda e njërit prej pretendimeve të mëparshme, që përfshin më tej një hap të transmetimit të bllokut të shënimeve në një shfletues web (161) të aftë për anotim bazuar në një grup rregullash të kontrollit të aksesit që përcaktojnë nëse një llogari përdoruesi e lidhur me një përdorues (59) të shfletuesit web (161) të aftë për

anotim ka leje për të parë bllokun e shënimeve
6. Një medium jo i përkohshëm i lexueshëm nga kompjuteri që ka të dhëna të ruajtura në të, që përfaqëson një softuer të ekzekutueshëm nga një aplikacion shfletuesi web (161) me aftësi anotimi, që funksionon në të paktën një proçesor të një pajisjeje klienti, duke qenë pjesë e një arkitekture klient-server, që përfshin gjithashtu një server anotimi (61) dhe një bazë të dhënash elektronike (62), softueri programohet për të krijuar një tur të udhëzuar përmes një serie seti faqesh web në Internetin global, ndërsa tërheq vëmendjen e përdoruesit në pikat kryesore të interesit në secilin set faqesh web, kur ekzekutohet nga aplikacioni i shfletuesit web (161), ku mediumi jo i përkohshëm i lexueshëm nga kompjuteri karakterizohet nga udhëzime që përfshijnë: për të ndjekur gjendjen e një blloku shënimesh, ku gjendja e bllokut të shënimeve ka një gjendje të zgjedhur nga një grup gjendjesh që përfshin: bllokun aktiv të shënimeve të pranishëm; dhe bllokun aktiv të shënimeve jo të pranishëm; për të vendosur një bllok shënimesh aktiv, ku blloku i shënimeve aktiv është i pranishëm kur gjendja e bllokut të shënimeve ka gjendjen e bllokut të shënimeve aktiv të pranishëm, ku blloku i shënimeve aktiv zgjidhet nga një grup prej një ose më shumë blloqesh shënimesh të aksesueshëm për një llogari përdoruesi që përdor aplikacionin e shfletuesit web të aftë për anotim (161), ku blloku i shënimeve përfshin një listë referencash për objektet e anotimit, dhe ku një objekt anotimi përfshin: një Uniform Resource Locator, referuar më poshtë si URL, për një dokument (64) që përfshin një faqe web ose një dokument PDF dhe përfaqësohet nga një strukturë DOM; një element të dhënash për përfaqësimin e një pjese teksti të zgjedhur (38) nga dokumenti (27), ku pjesa e zgjedhur e tekstit është përfaqësuese e një objekti anotimi; një informacion për gjetjen e pjesës së zgjedhur të tekstit në dokumentin e paraqitur në aplikacionin e shfletuesit web që mund të përmbajë anotacione (161), informacion që përfshin informacionin DOM; dhe një grup prej një ose më shumë pamjesh ekrani të dorëzueshme, ku një pamje ekrani e dorëzueshme korrespondon me një pamje ekrani të shënuar në një grup ruajtjeje, dhe ku pamja e ekranit e dorëzueshme përfshin një përzgjedhje të paracaktuar nga një grup që përfshin: vetë pamjen e shënuar të ekranit; dhe një URL për marrjen e pamjes së shënuar të ekranit nga një Rrjet i Shpërndarjes së Përmbajtjes, i referuar më poshtë si CDN, (63), ku grupi i ruajtjes përfshin një ose më shumë pamje të ekranit të shënuara të krijuara nga një pamje e ekranit fillestare e shënuar që përfshin një pjesë të dokumentit që tregon pjesën e zgjedhur të tekstit (38), dhe ku pjesa e zgjedhur e tekstit është e shënuar vizualisht (37) ; për të shfaqur një grup shfaqjesh të paketave të pamjeve të ekranit të shoqëruara me bllokun aktiv të shënimeve, ku grupi i shfaqjes së paketave të pamjeve të ekranit përbëhet nga një numër paketash shfaqjesh të pamjeve të ekranit, me secilën pako shfaqjesh të pamjeve të ekranit të shoqëruar me një objekt anotimi, ku një grup shfaqjesh të pamjeve të ekranit përfshin: një pamje në miniaturë e ekranit e shënuar bazuar në një pamje të ekranit të dorëzueshëm; dhe pjesa e tekstit të zgjedhur nga dokumenti i objektit e anotimit të shoqëruar; ku elementët e grupit të shfaqjes së paketave të pamjeve të ekranit shfaqen si paketa të shfaqura të pamjeve të ekranit në një zonë shfaqjeje të aplikacionit të shfletuesit web të aftë për anotime (161), ku mediumi i lexueshëm jo i përkohshëm nga kompjuteri përfshin më tej udhëzime për të lejuar një përdorues (59) të shfletuesit web (161) të aftë për anotime me karakteristika blloku shënimesh të zgjedhë të

shtojë një referencë objekti anotimi në listën e referencave të objekteve të anotimeve të bllokut aktiv të shënimeve, duke bërë që shfletuesi web (161) me karakteristikat e bllokut të shënimeve të dërgojë një udhëzim shtimi (181) në serverin e anotacionit (61) për të shtuar një referencë objekti anotimi në bllokun aktiv të shënimeve, i cili nga ana tjetër dërgon një udhëzim shtimi (182) në bazën e të dhënave elektronike (62)

7. Mediumi i lexueshëm jo i përkohshëm nga kompjuteri i pretendimit 6, ku objekti i anotacionit përfshin gjithashtu një koment anotimi, dhe ku pakoja e shfaqjes së pamjes së ekranit përfshin gjithashtu komentin e anotimit

8. Mediumi i lexueshëm jo i përkohshëm nga kompjuteri i pretendimit 7, ku udhëzimet (181, 182) për të lejuar përdoruesin (59) të zgjedhë të shtojë një referencë objekti anotimi në listën e referencave për objektet e anotimit të bllokut aktiv të shënimit ofrohen nga një buton shto në bllok shënimi (158) të vendosur në një shirit kontrolli anotacionesh të variantit kontekstual (34) në një kuti komentesh anotacionesh (31) që përfshin: komentin e anotimit (32) ; dhe shiritin e kontrollit të anotacioneve të variantit kontekstual (34) që përfshin një grup butonash (34) që i ekspozojnë funksionalitetin përdoruesit (59) dhe që përfshin të paktën një nga shtimi i referencës së objektit të anotimit në listën e referencave për objektet e anotimit të bllokut aktiv të shënimit

9. Mediumi i lexueshëm jo i përkohshëm nga kompjuteri i pretendimit 7 ose 8, ku mediumi i lexueshëm jo i përkohshëm nga kompjuteri përfshin më tej udhëzime për të lejuar përdoruesin (59) të shfletuesit web (161) me karakteristikat e bllokut të shënimit të klikojë një paketë të shfaqur të pamjeve të ekranit në zonën e shfaqjes duke bërë që shfletuesi web (161) me karakterstikat e bllokut të shënimit të kryejë veprime që përfshijnë: hapjen e një skede për URL-në e anotacionit të përfaqësuar nga paketa e shfaqjes së pamjes së ekranit; lëvizjen te vendndodhja e pjesës së zgjedhur të tekstit nga dokumenti; dhe shfaqjen e tekstit të theksuar të anotacionit dhe kutisë së komenteve të anotacionit

10. Një sistem për krijimin e një turi të udhëzuar përmes një serie setesh faqe web në Internetin global, duke tërhequr vëmendjen e përdoruesit në pikat kryesore të interesit në secilin set faqe web, sistemi që përfshi një arkitekturë klient-server që përfshin një server anotacioni (61), një bazë të dhënash elektronike (62) dhe të paktën një pajisje klienti në të cilën funksionon një shfletues web (161) i aftë për anotacione, karakterizuar nga hapa që përfshijnë: serveri i shënimeve (61) që vepron për të marrë nga shfletuesi web (161) i aftë për anotacione një udhëzim krijimi (167) për të krijuar një objekt blloku shënimesh që përfshin një listë referencash për objektet e anotimit që janë ruajtur tashmë duke përdorur bazën e të dhënave elektronike (62), ku një objekt anotimi përfshin: një Uniform Resource Locator, referuar më poshtë si URL, për një dokument që përfshin një faqe web ose një dokument PDF dhe të përfaqësuar nga një strukturë DOM; një element të dhënash për përfaqësimin e një pjese teksti të zgjedhur (38) nga dokumenti, ku pjesa e tekstit të zgjedhur është përfaqësuese e një objekti anotimi; informacion për gjetjen e pjesës së tekstit të zgjedhur në dokumentin e paraqitur në shfletuesin web (161) të aftë për anotim, informacioni që përfshin informacionin DOM; dhe një grup prej një ose më shumë pamjesh ekrani të dorëzueshme, ku një pamje ekrani e dorëzueshme korrespondon me një pamje ekrani të shënuar në një grup ruajtjeje, dhe ku pamja e ekranit e dorëzueshme përfshin një përzgjedhje të

paracaktuar nga një grup që përfshin: vetë pamjen e shënuar të ekranit; dhe një URL për marrjen e pamjes së ekranit të shënuar (193) nga një Rrjet i Shpërndarjes së Përmbajtjes, i referuar më poshtë si CDN, (63), ku grupi i ruajtjes përfshin një ose më shumë pamje të ekranit të shënuara të krijuara nga një pamje fillestare e ekranit e shënuar që përfshin një pjesë të dokumentit që tregon pjesën e zgjedhur të tekstit, dhe ku pjesa e zgjedhur e tekstit është e shënuar vizualisht (37) ; server i anotimeve (61) vepron për të krijuar objektin e bllokut të shënimeve duke dërguar udhëzime (168) për të krijuar objektin e bllokut të shënimeve në bazën e të dhënave elektronike (62) ; serveri të anatocionit (61) vepron për të marrë nga shfletuesi web (161) i aftë për shënime një udhëzim shtimi (181) për të shtuar një referencë në objektin e anotacionit në listën e referencave për objektet e anotacioneve të objektit të bllokut të shënimeve, dhe më tej vepron për të dërguar një udhëzim shtimi (182) në bazën e të dhënave elektronike. (62) ; dhe baza e të dhënave elektronike (62) që funksionon për të ruajtur objektin e bllokut të shënimeve që korrespondon me bllokun e shënimeve pas marrjes së udhëzimeve përkatëse të shtimit nga serveri të anatocionit (61)

11. Sistemi sipas pretendimit 10, ku një pamje e shënuar e ekranit në grupin e ruajtjes është një pamje e shënuar e ekranit në miniaturë (37)

12. Sistemi i pretendimit 10 ose 11, ku lista e referencave për objektet e anotacioneve është fillimisht bosh

13. Sistemi i njërit prej pretendimeve 10 deri në 12, që përfshin më tej serverin e anotimeve (61) operativ për të marrë një udhëzim fshirjeje për të hequr një referencë në listën e referencave për objektet e shënimeve të bllokut të shënimeve duke përdorur një ose më shumë sisteme kompjuterike dhe duke përditësuar objektin e bllokut të shënimeve në bazën e të dhënave elektronike për të reflektuar ndryshimin e shkaktuar nga udhëzimi i fshirjes

14. Sistemi i njërit prej pretendimeve 10 deri në 13, që përfshin më tej serverin e anotimeve (61) që vepron për të transmetuar një bllok shënimesh në një shfletues web (161) të aftë për anotacione bazuar në një grup rregullash të kontrollit të aksesit që përcaktojnë nëse një llogari përdoruesi e lidhur me një përdorues të shfletuesit web (161) të aftë për anotacione ka leje për të parë bllokun e shënimeve

---

(11) **13811**
(97) EP3752180//22.07.2026
(96) 19754909.0//08.02.2019
(22) 14.09.2026
(21) AL/P/2026/567
(54) **METODAT PËR TRAJTIMIN E KANCERIT ME ANTITRUPA ANTI-PD-1**
02.11.2026
(30) US 201862630038 P 13/02/2018, US 201862732828 P 18/09/2018
(71) Merck Sharp & Dohme LLC/126 East Lincoln Avenue
Rahway, New Jersey 07065 / US US//

(72) Mallika LALA/126 East Lincoln Avenue Rahway, New Jersey 07065-0907 / US,
Lokesh JAIN/126 East Lincoln Avenue Rahway, New Jersey 07065-0907 / US,

Mengyao LI/42 Forest Drive, Apt. B Springfield, New Jersey 07084 / US,
(74) Gentjan Hasa//
DINES 03910032; Nd. 38; H. 1; ; FARKË; FARKË E MADHE; 1045; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Pembrolizumab për përdorim në trajtimin e kancerit te një pacient përfshin administrimin e 400 mg pembrolizumab te pacienti afërsisht çdo gjashtë javë.
2. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku kanceri është përzgjedhur prej grupit të përbër nga: melanoma, kancer i mushkërive me qeliza jo të vogla, kancer i kokës dhe qafës, kancer urotelial, kancer i gjirit, kancer gastrointestinal, mieloma multiple, kancer hepatocelular, limfoma jo-Hodgkin, kancer i veshkave, limfoma Hodgkin, mezotelioma, kanceri i vezoreve, kanceri i mushkërive me qeliza të vogla, kanceri i ezofagut, kanceri anal, kanceri i traktit biliar, kanceri kolorektal, kanceri i qafës së mitrës, kanceri i tiroides, kanceri endometrial, karcinoma e qelizave skuamoze, ose kancer i gjëndrave të pështymës.
3. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku pacienti ka një tumor me një ngarkesë të lartë mutacionale.
4. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku pacienti ka një tumor solid me paqëndrueshmëri të lartë të mikrosateliteve (MSI-H) ose me deficiencë të riparimit të mospërputhjeve.
5. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku kanceri është i paoperueshëm ose melanoma metastatike.
6. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku kanceri është kancer metastatik i mushkërive me qeliza jo të vogla (NSCLC) .
7. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku kanceri është kanceri i qelizave skuamoze të kokës dhe qafës i përsëritur ose metastatik (HNSCC) .
8. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku kanceri është limfoma Hodgkin klasike e përsëritur ose rezistente (cHL) .
9. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku kanceri është karcinoma uroteliale metastatike ose lokalisht e avancuar.
10. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku kanceri është kancer i stomakut metastatik ose lokalisht i avancuar ose adenokarcinoma e bashkimit gastroezofageal.
11. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku kanceri është kancer i qafës së mitrës.
12. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku kanceri është limfoma mediastinale primare e qelizave B të mëdha (PMBCL) .
13. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku kanceri është melanoma në fazën III hequr kirurgjikalisht me rrezik të lartë.
14. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku kanceri është karcinoma hepatocelulare.
15. Pembrolizumab për përdorim sipas ndonjë prej pretendimeve nga 1-2, ku kanceri është karcinoma e qelizave renale (RCC) .
16. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku kanceri është karcinoma e qelizave Merkel e përsëritur, metastatike ose lokalisht e avancuar (MCC) .
17. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku pembrolizumab është terapi ndihmëse për melanomën, ku pacienti më parë i është nënshtruar heqjes së

një ose më shumë lezioneve melanomatoze.
18. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku kanceri është limfoma Hodgkin klasike (cHL), ku pacientit i është rikthyer sëmundja pas (a) një ose më shumë linjave terapie për cHL, (b) 2 ose më shumë linjave terapie për cHL, ose (c) 3 ose më shumë linjave terapie për cHL.
19. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku kanceri është kancer gastrik.
20. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 1, ku kanceri është kancer i ezofagut.
21. Pembrolizumab për përdorim sipas pretendimit 20, ku kanceri është është adenokarcinoma e avancuar ose metastatike ose karcinoma e qelizave skuamoze të ezofagut.

---

(11) **13738**
(97) EP4308715/ 13.05.2026
(96) 22715347.5/ 18.03.2022
(22) 05.07.2026
(21) AL/P/2026/400
(54) **Molekulë hibride që përfshin një fragment FC të antitrupit dhe të paktën një peptid të citrullinuar të derivuar nga fibrina, dhe përdorimet e saja**
09.10.2026
(30) France FR20210002803 19/03/2021
(71) Université Paul Sabatier Toulouse III/118 route de Narbonne, 31400 Toulouse / FR FR; Institut National de la Santé et de la Recherche Médicale (INSERM)/101 rue de Tolbiac, 75013 Paris / FR FR; Centre Hospitalier Universitaire de Toulouse/2 rue de Viguerie, Hôtel Dieu Saint Jacques, 31300 Toulouse / FR FR; Centre Hospitalier Universitaire de Montpellier/191 Avenue Du Doyen Gaston Giraud, 34090 Montpellier / FR FR; UNIVERSITE DE MONTPELLIER/163, rue Auguste Broussonnet, 34090 Montpellier / FR FR; Arthritis Recherche & Developpement/10-12 rue de Chartres, 92200 Neuilly sur Seine / FR FR

(72) Eve COMBES/34560 VILLEVEYRAC, FR, VILLEVEYRAC,
Bruno ROBERT/34298 MONTPELLIER CEDEX 5 / FR, MONTPELLIER,
Pierre MARTINEAU/34090 MONTPELLIER / FR, MONTPELLIER,
Pascale LOUIS-PLENCE/34270 SAINT MATHIEU DE TREVIERS / FR, SAINT MATHIEU DE Treviers,
Martin VILLALBA/34070 MONTPELLIER / FR, MONTPELLIER,
Christian JORGENSEN/34980 SAINT-CLEMENT DE RIVIERE, SAINT-CLEMENT DE Riviere,
Anthony TROEGELER/31830 PLAISANCE DU TOUCH / FR, PLAISANCE DU TOUCH,
Cyril CLAVEL/31470 SAINT FOY DE PEYROLIERES / FR, SAINT FOY DE PEYROLIERES,
Guy, Bruno SERRE/René 31100 TOULOUSE / FR, TOULOUSE,
(74) Eno Dodbiba

ZHEGU; Nd. 1; H. 1; Ap. 7; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 1; NJËSIA BASHKIAKE NR. 1; 1004; TIRANË, TIRANË, TIRANË

(EN) (54) **HYBRID MOLECULE COMPRISING AN ANTIBODY FC FRAGMENT AND AT LEAST ONE FIBRIN-DERIVED CITRULLINATED PEPTIDE, AND USES THEREOF**

(EN) (57)

(EN) (57)

(57) 1. Një molekulë hibride që përfshin të paktën një fragment Fc të antitrupit, të lidhur në mënyrë kovalente me të paktën një peptid të derivuar nga fibrina, i cili përmban të paktën një mbetje citrulili, ku të paktën një distancues është i pranishëm opsionalisht midis fragmentit Fc dhe peptidit, ku ky peptid njihet nga autoantitrupat e proteinave anti-citrulinuese dhe rrjedh nga e gjithë ose nga një pjesë e sekuencës së zinxhirit α ose β të fibrinës së vertebrorëve, ku të paktën një mbetje arginili është zëvendësuar me një mbetje citrulili.

2. Një molekulë hibride sipas pretendimit të mësipërm, ku fibrina e vertebrorëve është një fibrinë e gjitarëve, më konkretisht një fibrinë njerëzore.

3. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku distancuesi është një polimer që përmban një ose më shumë njësi përsëritëse që përmbajnë grupin eter, distancuesi mundësisht është polietilen glikol i formulës PEGn, ku n përfaqëson një numër të plotë midis 1 dhe 100, preferueshëm midis 1 dhe 10 dhe veçanërisht 1, 2, 3, 4 ose 8.

4. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku peptidi përmban të paktën një mbetje citruline dhe zgjidhet nga grupi që përbëhet nga: a) një peptid i përcaktuar nga sekuencën X1PAPPPISGGGYX2AX3, (SEK Nr: 1) ku X1, X2 dhe X3, përfaqëson secili një mbetje citrulil ose një mbetje arginil, dhe të paktën një nga mbetjet X1, X2 ose X3, është një mbetje citrulili; b) një peptid i përcaktuar nga sekuenca GPX1VVEX2HQSACKDS (SEK Nr: 2) ku X1 dhe X2 përfaqësojnë secili një mbetje citrulili ose një mbetje arginili, dhe të paktën një nga mbetjet X1 ose X2 është një mbetje citrulili; c) një peptid i përcaktuar nga sekuenca SGIGTLDGFX1HX2HPD (SEK Nr: 3) ku X1 dhe X2 përfaqësojnë secili një mbetje citrulili ose një mbetje arginili, dhe të paktën një nga mbetjet X1 ose X2 është një mbetje citrulili; d) një peptid i përcaktuar nga sekuenca VDIDIKIX1SCX2GSCS (SEK Nr: 4) ku X1 dhe X2, përfaqësojnë secili një mbetje citrulili ose një mbetje arginili, dhe të paktën një nga mbetjet X1 ose X2 është një mbetje citrulili; e) një peptid i përcaktuar nga sekuenca X1GHAKSX2PVX3GIHTS (SEK Nr: 12) ku X1, X2 dhe X3 përfaqësojnë secili një mbetje citrulili ose një mbetje arginili, dhe të paktën një nga mbetjet X1, X2 ose X3 është një mbetje citrulili; f) një peptid që përfshin të paktën 5 aminoacide të njëpasnjëshme, duke përfshirë të paktën një mbetje citrulili, nga njëri prej peptideve a) deri në e) më sipër.

5. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve 1-3, ku peptidi është zgjedhur nga grupi që përbëhet nga: SEK Nr.: 5, SEK Nr.: 6, SEK Nr.: 7, SEK Nr.: 8, SEK Nr.: 9, SEK Nr.: 10, SEK Nr.: 11, SEK Nr.: 13, SEK Nr.: 14, SEK Nr.: 15, SEK Nr.: 16, SEK Nr.: 17, SEK Nr.: 18, SEK Nr.: 19, SEK Nr.: 20, SEK Nr.: 21, SEK Nr.: 22 dhe SEK Nr.: 23, më konkretisht të zgjedhur nga grupi që përbëhet nga: SEK Nr.: 5, SEK Nr.: 6, SEK Nr.: 14, SEK Nr.: 18 dhe SEK Nr.: 19.

6. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku fragmenti

Fc është një fragment Fc njerëzor, në veçanti i IgG, më konkretisht i IgG1.
7. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku fragmenti Fc është i tipit natyror ose i mutuar, ku fragmenti Fc i mutuar përfshin mundësisht të paktën mutacionet e mëposhtme: -L234A dhe L235A, ose -L234A, L235A dhe P329G, ose -G236A, S239D dhe 1332E, ose -G236A, S239D, A330L dhe 1332E, ose -S239D, H268F, S324T dhe 1332E, numërimi tregohet në sekuencën e një IgG1 njerëzor sipas indeksit të BE-së.
8. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku: - fragmenti Fc është i lidhur me të paktën një azid dhe peptidi është i lidhur me një alkin, siç është një ciklooktin dhe në veçanti DBCO, ose -fragmenti Fc është i lidhur me të paktën një alkin, siç është një ciklooktin, dhe në veçanti DBCO, dhe peptidi është i lidhur me një azid, ose -fragmenti Fc është i lidhur me të paktën një azid dhe peptidi është i lidhur me një distancues, i lidhur vetë me një alkin siç është një ciklooktin, dhe në veçanti DBCO, ose -fragmenti Fc është i lidhur me të paktën një alkin, siç është një ciklooktin, dhe në veçanti DBCO, dhe peptidi është i lidhur me një distancues, i lidhur vetë me një azid, ose -fragmenti Fc është i lidhur me të paktën një distancues, i lidhur vetë me një azid, dhe peptidi është i lidhur me një alkin, siç është një ciklooktin, dhe në veçanti DBCO, ose - fragmenti Fc është i lidhur me të paktën një distancues, i lidhur vetë me një alkin, siç është një ciklooktin, dhe në veçanti DBCO, dhe peptidi është i lidhur me një azid, ose - fragmenti Fc është i lidhur me të paktën një distancues, i lidhur vetë me një azid, dhe peptidi është i lidhur me një distancues, i lidhur vetë me një alkin, siç është një ciklooktin, dhe në veçanti DBCO, ose - fragmenti Fc është i lidhur me të paktën një distancues, i cili vetë është i lidhur me një alkin, siç është një ciklooktin, dhe në veçanti DBCO, dhe peptidi është i lidhur me një distancues, i cili vetë është i lidhur me një azid, lidhja kovalente midis fragmentit Fc dhe peptidit, opsionalisht në prani të një ose më shumë distancuesve, krijohet midis azidit dhe alkinit.
9. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku kjo molekulë përfaqësohet nga: - një fragment Fc i tipit natyror që është i lidhur me të paktën një distancues PEGn që është vetë i lidhur me një azid të lidhur në mënyrë kovalente me një ciklooktinë që është i lidhur me një peptid të përfaqësuar nga SEK Nr.: 19 ose SEK Nr.: 18, - një fragment Fc që përfshin mutacionet $239D, H268F, S324T dhe I332E që është i lidhur me të paktën një distancues PEGn që është vetë i lidhur me një azid të lidhur në mënyrë kovalente me një ciklooktinë të lidhur me një peptid të përfaqësuar nga SEK Nr.: 19 ose SEK Nr.: 18, - një fragment Fc që përfshin mutacionet L234A, L235A dhe P329G që është i lidhur me të paktën një distancues PEGn që është vetë i lidhur me një azid të lidhur në mënyrë kovalente me një ciklooktinë të lidhur me një peptid të përfaqësuar nga SEK Nr.: 19 ose SEK Nr: 18, - një fragment Fc i tipit natyror që është i lidhur me një distancues PEGn që është i lidhur vetë me të paktën një azid të lidhur në mënyrë kovalente me një ciklooktinë të lidhur me një distancues PEGn që është vetë i lidhur me një peptid të përfaqësuar nga SEK Nr.: 19 ose SEK Nr.: 18, - një fragment Fc që përfshin mutacionet $239D, H268F, S324T dhe 1332E që është i lidhur me të paktën një distancues PEGn që është vetë i lidhur me një azid të lidhur në mënyrë kovalente me një ciklooktinë të lidhur me një distancues PEGn që është vetë i lidhur me një peptid të përfaqësuar nga SEK Nr.: 19 ose SEK Nr.: 18, n mundësisht përfaqëson një numër të plotë midis 1 dhe 10, më konkretisht 1, 2, 3

ose 4.
10. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme për përdorim si një produkt medicinal, në veçanti për përdorim në trajtimin e sëmundjeve autoimune të shoqëruara me prodhimin e autoantitrupave të proteinave anti-citrulinuese, në veçanti sindromën Gougerat-Sjögren dhe artritin reumatoid
11. Një molekulë hibride sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme për përdorim si një produkt medicinal në kombinim me një molekulë të dytë hibride, ku molekula e dytë hibride përfshin të paktën një peptid të derivuar nga fibrina që ka të paktën një mbetje citrulili, peptidi është i lidhur në mënyrë kovalente me të paktën një antitrup ose me të paktën një fragment antitrupi, ku ky antitrup ose fragment i antitrupit është i aftë të lidhet me CD38 dhe/ose CD138, ku një ose më shumë distancues janë opsionalisht të pranishëm midis peptidit dhe antitrupit të këtij fragmenti.

MARKA TREGTARE TË REGJISTRUARA

(210) AL/T/2024/452
(540)



(730) Fluidi Group L.L.C. // Velekincë, pn, Gjilan, KOSOVË, KS//

(151) 12.06.2026
(180) 09.04.2034
(111) 27997
(511) 32 - Ujëra natyrale burimore,dhe të aromatizuara me fruta ose vitamina apo mineralesh; shurupe dhe preparate të tjera për përgatitjen e tyre
(526) Ujë; natural
(591) e kaltërt; blu; e bardhë
(740) Gazmir Isakaj//
Rruga "Mihal Grameno", njësia administrative nr. 2, Tiranë.

---

(210) AL/T/2025/1272
(540) SONHO
(730) 7 Moons // Rruga e "Elbasanit", njësia bashkiake nr. 2, nr. i pasurise 6/30-N9/2, zona kadastrale, 8150, Tiranë., AL//

(151) 26.10.2026
(180) 14.08.2035
(111) 28425
(511) 14 - Metalet e çmuara dhe lidhjet e tyre; stoli; gurë të çmuar dhe gjysmë të çmuar; instrumente horologjike dhe kronometrike; stoli të bëra nga metale të çmuara, gurë të çmuar, perla, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar natyralë ose artificialë dhe imitime të tyre; bizhuteri te tilla si unaza grash, unaza burrash, vathe, varese grash dhe burrash, byzylyke grash, byzylyk meshkujsh; bizhuteri femijesh; medaljone; stema per skuadra dhe lojtare (bizhuteri), dekorata qe vendosen ne veshje; medalje qe vendosen ne veshje; trofe; trofe, statuja dhe skulptura te gjitha prej metali te cmuar; manshete; karfica zbukuruese; orë dorë; rripat e orës; zinxhirë orësh; kuti për stoli dhe orë; dekorues për unazat e celsave; unaza çelësash; zinxhirë çelësash; kuti bizhuterish; kunja per kravatë; kapëse kravatash; varëse bizhuteri; xhingla [bizhuteri]; stoli [bizhuteri]; stoli këpucësh; stoli për kafshët shtëpiake; zinxhirë çelësash si bizhuteri [xhingla apo stoli]; stolitë e veshjeve dhe çantave në formen e bizhuterive; artikuj dekorativë [xhingla ose bizhuteri] për përdorim personal.;
16 - Letër dhe karton; materiale të shtypura; materiale libërlidhjeje; fotografi; artikuj kancelarie dhe artikuj zyre, përveç mobiljeve; ngjitëse për artikuj shkrimi ose për qëllime shtëpiake; materiale vizatimi dhe materiale për artistë; penela; materiale mësimore dhe edukative; fletë plastike, filma dhe qese për mbështjellje dhe paketim; blloqe printimi; Broshura, katalogje, fisha, gazeta, libra, revista, udhëzues, botime periodike, publikime të shtypura; materiale të shtypura; programe eventesh; postera; kartolina; kartolina urimi; kartëvizita; ftesa; ditaret; kalendarët; albume fotografish; bllok shënimesh.;

35 - Shërbime marketingu; marketing online; marketing online në rrjete sociale, në tv, në radio; marketing në tabela reklamash e postera; organizimi i panaireve tregtare për qëllime tregtare ose reklamimi; shërbimet e agjensisë së import exportit; shërbime të kontabilitetit, mbajtjes së librave dhe auditimit; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të: Metaleve të çmuara dhe lidhjet e tyre; stoli; gurëve të çmuar dhe gjysmë të çmuar; instrumenteve horologjike dhe kronometrike; stolive të bëra nga metale të çmuara, gurëve të çmuar, perlave, gurëve të çmuar ose gjysmë të çmuar natyralë ose artificialë dhe imitime të tyre; bizhuterive te tilla si unaza grash, unaza burrash, vathë, varëse grash dhe burrash, byzylykë grash, byzyluk meshkujsh; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të bizhuterive të fëmijëve; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të medaljoneve; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të stemave për skuadra dhe lojtarë (bizhuteri), dekorata që vendosen në veshje; medalje që vendosen në veshje; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të trofeve, statujave dhe skulpturave te gjitha prej metali te çmuar; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të manshetave; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të karficave zbukuruese; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të orave të dorës; rripat e orës; zinxhirë orësh; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të kutive për stoli dhe orë; dekorues për unazat e celsave; unaza çelësash; zinxhirë çelësash; kuti bizhuterish; kunja per kravatë; kapëse kravatash; varëse bizhuteri; xhingla [bizhuteri]; stoli [bizhuteri]; stoli këpucësh; stoli për kafshët shtëpiake; zinxhirë çelësash si bizhuteri [xhingla apo stoli]; stolitë e veshjeve dhe çantave në formen e bizhuterive; artikuj dekorativë [xhingla ose bizhuteri] për përdorim personal; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të produkteve ushqimore; shërbime të shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të produkteve te furrave (dyqaneve) te bukes; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të të pijeve alkoolike dhe jo alkoolike; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të produkteve të pasticerisë dhe ëmbëltoreve; shërbime të shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të pajisjeve elektronike; shërbime te shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve elektroshtepiake; shërbime të shitjes me pakicë dhe shumicë në lidhje me pajisjet audio-vizuale, hardueret dhe softueret kompjuterike; shërbime të shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të pastrimit; shërbime të shitjes me pakicë për preparate farmaceutike, veterinare dhe sanitare dhe pajisjeve mjekësore;shërbime të shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të veshjeve; shërbime të shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të këpucëve; shërbime të shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të cantave; gjithashtu në internet, të syzeve optike dhe dielli; shërbime të shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, të produkteve kozmetike dhe te bukurise; shërbime të shitjes me shumicë dhe pakicë, gjithashtu në internet, gjithashtu në internet të bizhuterive; shërbimet e shitjes me pakicë për veprat e artit të ofruara nga galeritë e artit; shërbime të shitjes me shumicë dhe

